

SUBJEKTI “ KUMEGA “ Sh.p.k.
BURREL

Aktiviteti : Shfrytezim mineral kuarci ne objektin “ DUKAGJIN ”,
Rrethi Mat.

RAPORT I TELLUAR I VLERESIMIT

TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Shtojca I , pika 2- Industria nxjere; 1.9- Minierat siperfaqesore



Raporti i Thelluar i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u Hartua nga
Studio

“ REAL – P “ sh.p.k.

ADMINISTRATORI

Ing, REMZI PUPLI

Janar 2018

A blue circular stamp with a signature over it. The stamp is partially obscured by the signature, which is written in blue ink. The stamp appears to be an official seal or signature mark.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Nr.	PERMBAJTJA	FAQJA
1	Hyrje	5
2	INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-SË DHE METODIKËN E ZBATUAR	6
2.1	PËRSHKRIMI I QËLLIMIT TE PROJEKTIT	6
2.2	OBJEKTIVAT E VNM JANË:	8
2.3	PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN	11
2.4	LEGJISLACIONI KRYESOR SHQIPTAR PËR HARTIMIN DHE KLASIFIKIMIN E RAPORTIT TË VNM-SË:	12
2.5	PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	14
2.6	PËRSHKRIM TË METODIKES TË ZBATUAR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TE THELLUAR TË VNM-SË	18
2.7	METODIKAT E ZBATUARA DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT	20
3	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE I VENDODHJES SE TIJ	21
3.1	PËRSHKRIMIN E PROCESVEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE / PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT;	24
3.2	INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACION PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA;	29
3.3	PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES PAS	30

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

	MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT;	
3.4	MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË PROJEKTIT;	30
3.5	LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI);	31
3.6	INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH /PRANË ZONËS SË PROJEKTIT;	31
3.7	INFORMACION LIDHUR ME ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATË PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET;	31
3.8	PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE;	33
3.9	AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCEVE ETJ.; INFORMACION PËR LEJET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, TË KËRKUARA NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT.	33
4	NJË PËRSHKRIM I ANALIZIMIT TË ALTERNATIVAVE TË MUNDSHME PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT OSE KOMPONENTËVE TË VEÇANTA TË TIJ (SI: MJEDISI I RAJONIT, AKSESI RRUGOR, ADMINISTRIMI I MBETJEVE DHE UJËRAVE TË NDOTURA, LLOJET E LËNDËVE DJEGËSE, VENDNDODHJA E PROJEKTIT ETJ.), SI DHE SQARIMI I ARSYEVË KRYESORE PËR ALTERNATIVËN E PROPOZUAR, DUKE MARRË PARASYSH NDIKIMET NË MJEDIS TË SECILËS ALTERNATIVË, SI DHE,	34
4.1	PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT, HIDROGRAFIA, HIDROGJEOLGJIA	34
4.2	DEMOGRAFIA, INFRASTRUKTURA EKZISTUESE	34
4.3	INFRASTRUKTURA EKZISTUESE	34
4.4	EKONOMIA E ZONËS DHE AKTIVITETET KRYESORE	35
4.5	MJEDISI BIOLOGJIK	35
4.5.1	ZONAT E MBROJTURA	35

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

4.5.2	NJË PËRSHKRIM TË GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TË MJEDISIT, QË MUND TË NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR, DUKE PËRFSHIRË:	36
4.5.3	PËRSHKRIMIN E KARAKTERISTIKAVE FIZIKE TË ZONËS SË PROJEKTIT:	36
4.5.4	PËRSHKRIMIN E BIODIVERSITETIT NË ZONËN E PROJEKTIT:	39
4.5.5	PËRSHKRIMIN E CILËSISË SË MJEDISIT DHE NDIKIMEVE EKZISTUESE	41
5	PËRSHKRIM I KARAKTERISTIKAVE SOCIALE TË ZONËS KU PROPOZOHEM PROJEKTI	44
6	PËRDORIMI I TOKËS NË ZONËN E PROJEKTIT;	44
7	NJË PËRSHKRIM TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË RËNDËSISHME TË PROJEKTIT TË PROPOZUAR MBI MJEDISIN	46
8	NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS:	46
9	NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT	51
10	NDIKIMET POZITIVE NË MJEDISIN E ZONËS SË PROJEKTIT.	52
11	MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV	52
12	PROGRAMIN E MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT.	54
13	PLANIN E MENAXHIMIT MJEDISOR	55
14	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT	58

1. HYRJJE

Mjedisi është burimi i gjithçkaje për të cilën njerezit kanë nevojë për të jetuar dhe për të zhvilluar. Sa më i degraduar të jete mjedisi aq më keq ndikon në shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social, prandaj duhet një menaxhim sa më mirë i mjedisit.

Vendi ynë është anetare i një numri konventash ndërkombëtare, si rrjedhojë është i detyruar të zbatojë një sistem sa më efektiv në fushat ekonomik-social-mjedisor, për rregullimin e territorit sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Ligji i Vlerësimit të ndikimit mjedisor nr.10 440 datë 07-07-2011 mbi “Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor” në Shqipëri thekson për përgatitjen e vlerësimeve mjedisore të çdo projekti të zhvillimit që mund të shkaktojnë ndikime në mjedisin e vendit.

Ky raport VNM-je do të identifikojë ndikimet e mundshme në mjedis të punimeve të propozuara për **ID 3.7, Veprimtaria “Nxjerrja e mineraleve, rërës, dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret. Të gjitha instalimet”** për të cilën subjekti do të nështrohet procedurës për tu pajisur sipas Ligjit Nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” me Vendim Thelluar të VNM-së nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), me theks të veçantë në rekomandimet mbi zvogëlimin e ndikimit dhe marrjen e masave të nevojshme për të minimizuar ndikimet që mund të lindin gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Raporti i VNM-së do të diskutojë gjithashtu mbi justifikueshmerinë e projektit, alternativat e vendosjes së komponentëve të projektit të tilla si planet e projektit dhe konsideratat mjedisore. Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe pas përfundimit të tij.

Ky raport VNM-je është përgatitur sipas kërkesave kombëtare të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit të përmendura më poshtë si dhe sipas legjislacionit të BE-së marrë si referencë. Legjislacioni Kombëtar i Shqipërisë përcakton rregullat dhe mënyrat për kryerjen e një VNM të kësaj natyre, të cilat konsulentët i kanë konfirmuar. Ligji ka theksuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe burimet e tij duke e konsideruar atë si pjesë e trashëgimisë kombëtare e cila duhet të ruhet dhe të mbrohet për të mirën e gjeneratave të ardhshme. Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve të tij është një pararendës kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Raporti i ndikimit në mjedis do të paraqesë nga njëra anë rendesinë e zbatimit të projektit **“Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”**, përshkrimin e këtij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore në mjedis, masat zbutëse për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundshme këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmejt tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Të paraqesë realizimin e këtij projekti dhe zhvillimin ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin “e zhvillimit të qëndrueshëm”.

Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët që marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij.

VNM-ja e thelluar është përpiluar bazuar në të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura nga ekspertët e kontraktuar të cilët gjatë inspektimeve në terren dhe vlerësimeve të kryera në **muajt Janar – Shkurt 2018**.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Megjithatë, vlerësime të bëra nga konsulentë të ndryshëm në vitet e mëparshme janë shfrytëzuar gjatë përgatitjes së raportit. Të dhënat afatgjata mbi disa aspekte të tilla si meteorologjia sizmiciteti zonës, të dhënat gjeomorfollogjike dhe klima janë mbledhur nga kalkulimet dhe studimet e realizuara nga inxhinieri projektues, si dhe nga burime dytësore përmes raporteve të publikuara më parë dhe të databazave globale.

Objekti ku do të zhvillohet aktiviteti ze nje sipërfaqe te mjaftueshme per implemetimin e projektit ne zbatim.

Duhet theksuar se ne te gjithë territorin e marre ne studim ka aktivitete me karakter te njejte me ate te marre ne studim. Ky projekt perligj statusin e kesaj zone te **Qarkut Diber**.

Ne brendesi te kesaj zone vihet re nje sistem rrugor i mirefillte.

Raporti i Thelluar i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte bazuar ne zhvillim strategjik te **Objektit "DUKAGJINI", Rrethi Mat, Qarku Diber** perfshin planifikimin, rehabilitimin dhe masat zbutese te ndikimit te projektit ne kete zone.

Do te paraqesim gjendjen e ndikimit te ketij projekti mbi mjedisin e zones dhe shendetin e njerezve, do te shqyrtojme faktoret pozitive dhe negative mjedisor, do te paraqesim skemat e rehabilitimit dhe masat zbutese dhe reduktimin e impakteve negative.

2. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-SË DHE METODIKËN E ZBATUAR

Gjëndja e mjedisit dhe përkujdesjet ndaj tij, janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerezimit sot. Zhvillimi ekonomik i cili po shoqerohet me rritje të vazhdueshme të numërit të ndërmarjeve operuese, si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm nëse nuk parashikon hapsira për mbrojtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit, si në ajër, ujë dhe tokë.

Mbrojtja e mjedisit si një sistem dinamik që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, i duhen analizuar jo vetëm faktorët natyror, por edhe aktiviteti njerezor i cili lidhet me to. Studimet dhe ndërtimet kur nuk menaxhohen konform ligjeve dhe rregullave të natyrës, ato mund të prishin ekuilibrin e natyrës përreth.

Planifikimi urban si një veprimtari komplekse, natyrore, inxhinjerie, klimatike, biologjike, sociale dhe legjislativë e shoqërisë njerezore të civilizuar, mbështetet në radhë të parë mbi mjedisin gjeologjik dhe ekosistemet e lidhur me të.

Ai ka dy aspekte veprimtarish:

Së pari, ndryshimet që njeriu i bën gjeomjedisit dhe ekosistemeve për ti pershtatur ato me kërkesat e tij jetësore, sipas filozofisë "njeriu e ndryshon natyrën" për të përmirësuar jetesën e tij.

Së dyti, impaktet e këtyre ndryshimeve mbi vetë mjedisin gjeologjik si dhe mbi jetën e njerezve.

Për të realizuar planifikimin urban dhe për të vlerësuar impaktet mbi gjeosistemin, janë të domosdoshme njohuritë mbi gjeomjedisin dhe ndryshimet që ai pëson me kohën. Këto njohuri nxirren nga vrojttime komplekse gjeologjike, gjeofizike, gjeokimike dhe hidrogeologjike.

2.1 PËRSHKRIMI I QËLLIMIT TE PROJEKTIT

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për **"Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret"**, është hartuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Qëllimi i këtij Raporti të Thelluar të VNM është të vlerësojë impaktet potenciale sociale dhe mjedisore nga implementimi i këtij projekti, të rekomandojë masat zbutëse për minimizimin e impakteve potenciale të vlerësuara, si gjatë fazës së implementimit të projektit ashtu dhe në fazën e funksionimit, duke synuar qëllimin final mbrojtjen e cilësisë së mjedisit.

Raporti Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bazuar në rendesine e hartimit të studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore me standarde bashkëkohore, për përmbushjen e kërkesave të investitorit për projektin që do të realizohet, pasurite natyrore dhe humane të zonës në studim, si dhe vlerat e veçanta të tyre.

Identifikimi i efekteve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke pasur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit, masat orientuese dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore si dhe bashkërendimi i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të zonës me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në Ligjin Nr.10448 datë 14.7.2011 dhe në mbështetje të nenëve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës "Për Lejet e Mjedisit" theksohet në mënyrë të qartë se cilat projekte dhe aktivitete i nënshtrohen për leje mjedisore dhe që jepen në shtojcën 1 dhe 2 të këtij ligji, përpara miratimit të tyre nga organet përkatëse".

Mbështetur në udhëzimin Nr. 4 datë 15.04.2013, si dhe nga konsultimet e bëra në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, arrijme në konkluzionin se:

"Ky projekt i marrë në vlerësim do të nënshtrohet një Raporti për "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret",

Ky Raport Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ka si synim kryesor: "Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve që do të zbatohen duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga ndotja".

Dihet si çdo projekt, edhe ky projekt për **"Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret"**, në realizimin e tij ka ndikime në mjedis që lidhen me cilesitë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut "Mbrotja e mjedisit nga ndotja dhe demtimi përben përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, personave fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Qëllimi i këtij dokumenti bazohet në planifikimin e territorit që i është nënshtruar zona, me qëllim **"Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret"**, me vendodhje në Mat.

Ky projekt ka si qëllim kryesor Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të shfrytëzimit të mineralit të kuarcit në zonën minerare të paisur me lejen minerare 126 datë 11.01.1995 në objektin **"Dukagjin"**, nënsia Administrative Darjan, Rrethi Mat, Qarku Diber, i cili parashikohet të fillojë funksionimin pasi Shoqëria të pajiset me Leje Minerare shfrytëzimi nga Qendra Kombëtare e Biznesit, duke siguruar marrjen në konsideratë në të gjithë faktorët mjedisore që kerkohen në Ligjin nr. 10431 dt. 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"

Shoqëria **"KUMEGA"** Sh.p.k. është e regjistruar në Q.K.B. me datë 25.01.1995, si person juridik dhe ka NIPT –i J68118904D : Kërkim, zbulim, shfrytëzim, tregtim dhe eksport import i mineraleve të ndryshme të lejuara nga legjislacioni në fuqi si dhe tregtimi me shumicë e pakicë, eksport importi i artikujve të ndryshëm. Nderime civile e industrial dhe turizmi, projekte të

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

ndryshme. Prodhim , transport e shitje te materialeve te ndertimit. Kryerje e punimeve elektrike, elektronike, zbatim e projektim. Instalimin e rrjeteve dhe paisjeve fundore ne telekomunikacion. Prodhim dhe tregtim me shumice e pekice te artikujve te ndryshem industrial, ushqimore, bujqesore e blektorale, pijeve alkolike dhe atyre freskuese, material te ndryshme te ndertimit dhe hidrosanitare, pjeseve te nderimit, etj. Ka filluar aktivitetin e shfrytezimit te mineralit te kuarcit ne objektin " Dukagjin" ne njesine administrative Darjan Rrethi Mat, me Lejen minerare te Shfrytezimit nr. 126 dt. 11.01.1995. Me mbarimin e afatit 20 vjeçar, subjekti ka kerkuar shtyrjern e afatit te lejes minerare te shfrytezimit dhe per rrjedhoje eshte paisur me lejen minerare te shfrytezimit me afat 10 vjeçar me nr. 126/1 date 10.10.2017. Gjate periudhes te zoterimit te Lejeve te Shfrytezimit kjo Shoqeri ka investuar per zhvillimin e ketij aktiviteti ne rruge, makineri e paisje, ndertesa etj, duke rritur nga viti ne vit grafiket e prodhimit dhe investimet. Shoqeria drejtohet nga nje staf i specializuar dhe me pervoje te gjate ne pune.

Projektet publike dhe private te personave fizik dhe juridik, vendas ose te huaj, qe kerkojne te ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe mund te ndikojne ne Mjedis, i nenshtrohen ne pregatitjen e nje Raporti te permbledhur te Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis, perpara miratimit dhe zbatimit te tyre.

Raporti i Thelluar i Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis perfshin indentifikimin, sakesimin dhe vleresimin e drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis.

Në këtë projekt japim konsideratat mjedisore për aktivitetin që do të kryhet, që të orientojmë institucionet dhe organet vendim marrëse në dhënien e miratimit të Lejes Mjedisore për të kryer këtë aktivitet.

Me këtë relacion sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Zbatimi i këtij projekti plotëson kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

2.2 OBJEKTIVAT E VNM – SE JANË:

Raporti i Thelluar i Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (VNM) ka siguruar nje mbledhje te te dhenave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e Projektit, perfshire kushtet lizike, atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social ekonomike te zones. Ne hartimin e studimit perdoret informacioni, te dhenat ekzistuese dhe te pritura referuar kushteve te sheshit te ndertimit, se bashku me standartet dhe normat e aplikueshme per te vleresuar ndikimet potenciale mjedisore, specifike dhe sociale te fasiliteve te propozuara. Ndikimet potenciale mjedisore te shqyrtuara dhe analizuara ne kete VNM, perfshijne ndikimet ndaj cilesise se ujit, burimeve nentokesore ujore, situates social-ekonomike, kulturore gjate zhvillimit te projektit dhe te aktiviteve lokale te pritura.

Burimet e vleresuar social-kulturore perfshijne punesimin, perdorimin e tokes, transportin dhe sherbimet e komunitetit te zones. VNM percakton masat zbutese per te parandaluar ose minimizuar gjate aplikimit te ndikimeve mjedisore dhe sociale te projektit te propozuar. Keto

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

raportohen ne detaje ne planin e menaxhimit te mjedisit, i cili eshte pjese e studimit. Vleresimi i ndikimit ne mjedis perbehet nga teresia e procedurave te veprimit, monitorimit, zbutjes dhe masave institucionale, qe do te zbatohen gjate Projektit per te eliminuar, kompensuar apo pakesuar ndikimet e kunderta potenciale mjedisore dhe sociale.

VNM trajton menaxhimin specifik te mjedisit, planet monitoruese, identifikon çdo kerkese dhe afatet e duhura te domosdoshme, si me poshte:

- Zona ku ndodhet Projekti, statusi i tij, pershkrimi i vendit dhe mjedisit te tij.
- Kuadri ligjor i politikave dhe planeve per zhvillimin ekonomik te zones.
- Arsyet qe ndikuan ne perzgjedhjen e ketij vendi per kryerjen kesaj veprimtarie.
- Pershkrimi, detajimi dhe trajtimi i disa operacioneve ditore te projektit qe do te Zhvillohet, ne raport me situaten mjedisore.
- Identifikimi i ndikimeve me te mundshme mjedisore qe mund te ndodhin ne mjedis nga ndertimi dhe vleresimi i mases se tyre.
- Plani i menaxhimit te mjedisit dhe percaktimi i masave per zbutjen dhe reduktimin e ndikimeve me te mundshme negative.

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM)

I percaktuar me fjale te thjeshta, VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar.

Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimit dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdesi veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet emundshme negative te veprimeve te ndermara.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara.
 - Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.
- Zhvillimi i Qendrueshem eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit dhe promovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

Rendesia e VNM

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane njaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen nje nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane Subjekt i nje vendimmarrje te nje autoriteti kombetar.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit.
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit.
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjete termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Te japë informacion mbi vendndodhjen e sheshit të projektit dhe të analizojë tiparet mjedisore;
- Te japë informacion mbi projektin teknik për fazën përgatitore, implementimin, marrjen e rezultateve të projektit, punimeve dhe mjeteve që do të përdoren, kompletimin dhe fazën përmbyllëse të tij;
- Te vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedisin përreth dhe në banorët e zonës për ndertimin e Godines;
- Te përshkruajë masat për reduktimin apo evitimin e impakteve të analizuara;
- Te hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
- Te hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
- Te informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
- Te nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
- Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
- Te minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
- Te ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

Ndikimet mjedisore te projektit do te vleresohen ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e implementimit te ketij projekti.

2.3 PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.

Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i degradimit mjedisor të vendit gjatë zhvillimit industrial që mori vendi në vitet 50-të. Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore dhe Nënligjore të Mjedisit gjatë 2000 – 2009, si dhe në disa ligje e VKM të miratuara më vonë se këto vite.

Shoqëria "KUMEGA" Sh.p.k pasi është pajisur me dokumentacionin e plotë në lidhje me pronësitë ku është projektuar të realizohen ndërhyrjet për projektin "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret", me kërkesë të vet Shoqërisë është kërkuar që të bëhet një Vlerësim Mjedisor, për vet ndjeshmërinë, që mund të ketë implementimi i këtij projekti në mjedisin e zonës përreth.

Klasifikimi i projektit:

Në bazë të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I pika ID 3.7, Veprimtaria "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret.Të gjitha instalimet" nënshtrohet Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Vendimi i VNM është dokumenti i përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, bazuar në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009.

"PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

Metodologjia e hartimit të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor të shprehura në Udhëzimin Nr.3, datë 19.11.2009 "Për Metodologjinë e Vlerësimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis". Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në zonën e projektit merr në konsideratë se si keto procese gjatë zbatimit të projektit ndikojnë në gjendjen

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

ekzistuese të mjedisit të zonës dhe më vonë. Ndikimet akumulative që mund të ndodhin mund të shfaqen menjëherë kur ndodh një ndërhyrje në mjedis apo shfaqen në mënyre indirekte dhe ato mund të shfaqin shkallë të ndryshme rëndësie. Këto ndikime mund të jenë të ndryshme në kohë zgjatjen e ndikimit (Afatshkurtër, Afatmesëm dhe Afatgjatë në kohë) dhe të ndryshme në karakterin e tyre (ndikim i përkohshëm dhe i përhershëm).

Hartimi i këtij raporti VNM-je është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" ku sipas nenit 8 të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës II i nënshtrohen Procedurës Thelluare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Gjithashtu hartimi i këtij raporti Thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i cili është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Hapat e ndjekura për përgatitjen e raportit nga Eksperti i Mjedisit janë bazuar në Kreun I "Zhvillimi i Procedurës Thelluare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis" të Vendimit Nr. 13, datë 4.1.2013 "Për Miratimin e Rregullave, Të Përgjegjësisë e Të Afateve Për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit Në Mjedis"

2.4 LEGJISLACIONI KRYESOR SHQIPTAR PËR HARTIMIN DHE KLASIFIKIMIN E RAPORTIT TË VNM-SË:

Ligji nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

- a) Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) Garantim i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Projektet që i nënshtrohen procedurës Thelluare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis sipas Kreut II, nenit 8 të këtij ligji, citojmë:

1. Procedurës Thelluare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i nënshtrohen:
 - a) Projektet e listuara në Shtojcën II;

Në mbështetje të ligjit nr.10440 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" nenit 10, pika "a" citojmë:

Paraqitja e kërkesës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, pranë QKL-së nga zhvilluesi.
Për projektet e Shtojcës II:

1. Raportin Thelluar të VNM-së.
2. Projektin teknik të veprimtarisë
3. Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Përmbajtja e raportit Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përcaktuar në Shtojcën I të VKM nr.13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis".

Ligji nr.10431 datë 10.03.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në bazë të këtij ligji, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit:

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdolloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit.

Parimet e mbështetura në Kreun II të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit":

- parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- parimi i kujdesit
- parimi i parandalimit
- parimi "ndotësi paguan"
- parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit të mjedisit të dëmtuar
- parimi i përgjegjësisë ligjore
- parimi i mbrojtjes në shkallë të lartë
- parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale
- parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore
- parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore.

"Zhvillimi i qëndrueshëm" i cili është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.

"Përdorimi i qëndrueshëm" i burimeve natyrore e minerare i cili siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa çenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime.

"Teknikat me të mira të mundshme" përfaqësojnë fazën me të përparuar dhe me nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, të zhvillimit të një veprimtarie dhe që janë plotësisht të zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.

"Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikime të dëmshme të një veprimtarie në mjedis.

"Parimi i riaftësimit" është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vetë personat fizikë e juridikë dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar .

"Parimi "Ndotësi paguan" nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

2.5 PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Gjate njezetvjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore Mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-te dhe zhvillimeve të fundit. Ligjet e përpiluara për Mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore Mjedisore 1991-2015.

Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se: "Shteti, brenda kompetencave Kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismes dhe të përgjegjësisë private, synon:

Një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të pershtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit.

Kështu, ndër më specifiket përmendim:

Tabela 1 Legjislacioni mjedisor¹

Baza Ligjore	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Ligji Nr.7875, datë 23.11.1994	Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9219 datë 08.04.2004
Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor", I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9791 datë 23.07.2007
Ligji nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhurnuar
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis

¹ Agjencia Kombëtare e Mjedisit akm.gov.al

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin
Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Ligji Nr. 7643, 09.12.1999 I ndryshuar	Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror
Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005	Për efikasitetin e energjisë
Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta i ndryshuar me :Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim:	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë nëProtokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr. 13, datë 4.01.2013	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.
V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006	"Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor
VKM Nr.123, datë 17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

VKM Nr.247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore
VKM Nr.114, datë 27.01.2009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.
Rregullore	
Rregullorja Higjieno-Sanitare datë.17.11.1997	Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave
Rregullore, Nr.I, datë 30.03.2007	Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre

Kuadri Ligjor Nderkombetar

Shqipëria është një vënd i cili është tashmë nënshkrues i shumë konvetave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Ky raport duhet të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe më poshtë ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit.

- Protokoll i Kievit: Për vlerësimin strategjik mjedisor. Ratifikuar në vitin 2005
- Protokoll i Kartagjens:Per biosigurine. Berë pale ne vitin 2005
- Konventa e Stockholmit: Mbi ndotësit organike të qëndrueshem. Ligji nr. 9263, datë 29.07.2004
- Protokoll i Kartagjens: Për sigurine biologjike. Ratifikuar ne vitin 2004.
- Ligji nr. 9279, date 23.09.2004
- Konventa e Eashingtonit: Për tregetinë ndërkombetare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Ligji nr. 9021, datë 06.03.2003.

Kuadri Ligjor European

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujrave të embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.

Konventat Ndërkombëtare

Brenda dekadës së fundit, Shqipëria është bërë shumë aktive në fushën e mjedisit dhe ka firmosur shumë konventa dhe protokolle ku mund të përmendim disa prej tyre:

- Konventën e Aarhus për akses në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendim marrje ambjentaliste dhe akses të drejtësisë në çështjet ambjentaliste, të ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, datë 26 tetor 2000,
- Konventën e Rio De Janeiro-s për Biodiversitetin, të ratifikuar me 10 Nëntor 1996,
- Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Në Bernë, 19 shtator 1979
- Konventa Ndërkombëtare Detare "Për Parandalimin E Ndotjeve Nga Anijet, 1973", Të Ndryshuar Me Protokollin E Vitit 1978 (Marpol 73/78) ratifikuar nga RSH me Ligjin Nr.9594, datë 27.7.2006;

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- Konventa Ndërkombëtare Detare "Për Përgatitjen Ndaj Ndotjes Nga Nafta, Reagimi Dhe Bashkëveprimi (Opre), 1990" Ratifikuar Nga RSH Me Ligjin Nr.9692, Datë 8.3.2007;
- Konventën Ndërkombëtare "Për Përgjegjësinë Civile për Dëmet nga Ndotjet me Karburant", 1992, Ratifikuar nga RSH me Ligj Nr.9293, datë 21.10.2004;

Referimet në nivel komunitar në fushën e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta dhe për qëllimet tona është e dobishme të përzgjidhen ato më kryesoret.

Disa nga parimet themelore, parimet bazë, që sugjerojnë linjat e veprimit dhe objektivat që përmbajnë programet komunitare, po i përshkruajme më poshtë.

2.6 PËRSHKRIM TË METODIKES TË ZBATUAR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TE THELLUAR TË VNM-SË

Metodologjia e VNM-së i referohet çështjeve mjedisore të sugjeruara nga objektivat e parashtruara në Kushtet e Referencës. Raporti i Mjedisit është përgatitur siç detajohet në ligjin përkatës. Për më tepër, raporti rrespekton edhe legjislacionin e BE dhe sigurisht atë Shqipëtar, siç kërkohet. Raporti është përgatitur në bazë të metodave shkencore të themeluara dhe pranuar gjerësisht të cilat përdoren për përgatitjen e vlerësimeve të tilla.

Raportit i thelluar të VNM-së është hartuar nga **Studio "REAL - P" Sh.p.k.**, licensuar nga Q.K.L. me nr.license LN-7383-01-2014, për shërbime ekspertize profesionale lidhur me Ndikimin në Mjedis.

Metodat e mbledhjes së të dhënave janë të përshkruara në kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti. Të dhënat janë mbledhur kryesisht nga inspektimet në terren në zonën e zhvillimit të projektit në **Janar -Shkurt 2018** nga një ekip inxhinierësh dhe ekspertë të mjedisit në bashkpunim me inxhinierin projektues. Megjithatë, të dhëna të publikuara më parë dhe literatura në dispozicion nga projekte të ngjashme janë referencuar gjatë përgatitjes së këtij raporti të VNM-së.

Në studimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, u orientua nga rëndësia e veçantë që paraqet për projektin "**Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret. Të gjitha instalimet**" dhe janë marrë në konsideratë pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis hartohet me kërkesë të Shoqërisë "**KUMEGA**" Sh.p.k. për zhvillimin e aktivitetit minierar në objektin "**Dukagjin**", zona minerare në Rrethin Mat, Qarku Diber.

Prodhimi i kuarcit në zonën e projektuar do të ketë destinacion kryesor përdorimin në uzinat e ferokromit në vendin tone. Shfrytëzimi mineralit do të bëhet me punime sipërfaqësore, karrierë.

Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua nga rëndësia dhe madhësia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Per pergatitjen e raportit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis per aktivitetin e shfrytezimit te Kuarcit me kariere shoqeria vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit te thelluar te VNM, studimin tekniko - ekonomik dhe projektin e shfrytezimit, fotografi, harta, skica te terrenit etj., qe dispononte lidhur me zhvillimin e veprimtarise. Grupi i projektimit me specialiste dhe eksperte te angazhuar per kete studim, pasi u njohen me permbajtjen e materialeve , llojin e veprimtarise qe do te kryhet, fazat e zbatimit te projektit dhe kohën e ndertimit dhe funksionimit te tij , bene rikonicionin e zones ku do te kryhet veprimtaria dhe te zones per rreth dhe u percaktuan drejtimet qe do te trajtohen ne kete studim.

Nga eksperte, specialiste dhe nga burime njerezore te qarkut Diber, u moren te dhenat e nevojshme per gjendjen faktike te teritorit ku do zbatohet projekti.

Në këtë raport, identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut.

Reduktimi i ndikimeve negative, është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive te cilat strukturohen në katër faza kryesore:

1. Ngritja e objektivave orientuese të raportit të VNM;
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe plotësimi i formularit përkatës për këtë raport si dhe seleksionimi i tyre për përdorim;
3. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme;
4. Hartimi i VNM dhe dorëzimi per marrjen e Vendimit Thelluar të VNM-së, si dhe subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele lokale.

Nga Institucionet e specializuara, sipas porosisë së AKM/MM, mund të kryhen monitorimet si më poshtë:

- Monitorimi i zhurmave nga specialistët e kësaj fushe pranë Inspektoriateve përkatëse;
- Monitorimi i punimeve, nga pikpanja e karakteristikave fizike, kimike e ndotesit potencialë, gjithçka në normat dhe standartet ndërkombëtare në mënyrë që ai të shërbejë realisht për performancën e larte e shëndetit publik;
- Monitorimet mbi biodiversitetin, do të fillojnë pas fillimit të masave rehabilituese dhe me kohë do të vendoset fokusi dhe hapësirat e zhvillimit të tyre.

Shoqëria nën mbikqyrjen e supervizorëve do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë, çdo inisiativë monitoruese mjedisore, që do t'i këshillohet në " Vendimin per raportin e thelluar të VNM-së ", në shërbim të së cilës është kryer edhe ky raport. Gjithashtu, inspektimet nga specialistët e autorizuar të shëndetit publik dhe mjedisit do të mbështeten në çdo kohë nga kjo Shoqëri, për realizimin e auditimeve mjedisore dhe shëndetësore.

Raporti i thelluar i VNM-së përfshin të dhënat e mëposhtme në përputhje me udhëzimin Shqiptar mbi VNM:

- Fushëveprimi i projektit, data e supozuar e fillimit

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- Përshkrimi i zonës së projektit shoqëruar me një hartë dhe fotot e objektit
- Përshkrimi i proceseve teknologjike
- Lloji, vëllimi, konsumi dhe prodhimi i materialeve të papërpunuara
- Informacion të detajuar në lidhje me shkarkimet në mjedis
- Informacion në lidhje me cilësinë e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën e projektit ku do të zhvillohet shkarkimi në mjedis.
- Informacion në lidhje me lokacionet ku do të ndodhin shkarkimet
- Rreziqet e mundshme për mjedisin dhe nevojën për të shmangur dhe minimizuar ndikimin e tyre në mjedis
- Masat zbutëse për kapjen dhe trajtimin e shkarkimeve në mjedisit dhe të ndotjes
- Një program për monitorimin e shkarkimeve në mjedis
- Nje plan për menaxhimin e mbetjeve

2.7 METODIKAT E ZBATUARA DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT

Metodika e zbatuar për përpilimin e strukturës së raportit të VNM-së është bazuar në kërkesat e VKM Nr. 13 Datë 4.01.2013, Shtojca I.

Hapat e ndjekur për hartimin e raportit të VNM-së:

Hapi 1	Njohja me projektin teknik
Hapi 2	Konsultimi me kuadrin ligjor
Hapi 3	Rishikim i gjendjes aktuale mjedisore, për të evidentuar ndryshimet e mundshme, evulimet apo përmirësimet e saj nëpërmjet inspektiveve në terren
Hapi 4	Evidentimi i impakteve negative të mundshme gjatë zhvillimit të projektit
Hapi 5	Evidentimi i impakteve kumulative të mundshme nga aktivitetet e tjera që kryhen aktualisht në rajonin e projektit
Hapi 6	Hartimi i masave për zbutjen e impakteve në mjedis dhe monitorimin në mjedis
Hapi 7	Konsultimet dhe përfshirja e aktorëve dhe gjithë grupeve të interesit.

Hartuesit e kësaj VNM pasi studiuuan projektin teknik, i cili do të implementohet dhe prezantohet nëpërmjet këtij raporti, gjetën dhe bënë përputhshmërinë ligjore, kërkesat dhe normat që duhet të zbatohen gjatë zhvillimit të këtij projekti.

Zona ku do të implementohet per projektin "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret.Të gjitha instalimet"është një zonë e njohur për hartuesit e këtij raporti, të cilët kanë eksperiencë dhe njohuri të mira për gjendjen aktuale të mjedisit fizik dhe karakteristikave të tjera mjedisore të saj.

Hartuesit e këtij raporti bën konsultime edhe me specialistët e komunitetit vendas, përfaqësues të njesise administrative për çështje specifike, si dhe për të marrë opinionin e tyre lidhur me projektin. Gjatë hartimit të këtij raporti u bë një analizë e detajuar e të gjithë projektit teknik, për të nxjerrë impaktet e mundshme në mjedis, për të përcaktuar sa të rëndësishme janë këto impakte dhe për të parashikuar kohëzgjatjen dhe kthyeshmërinë ose jo të tyre.

Lidhur me këtë, grupi hartues i VNM-së, u bazua edhe në literaturën bashkëkohore, në vende

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

analoge ku aplikohen këto projekte. U morën në konsideratë praktikat më të mira të punës edhe gjatë hartimit të masave parandaluese, zbutëse dhe rehabilituese të impakteve të evidentuara.

Krahas komunikimeve të vazhdueshme me kompaninë zhvilluese për marrjen e informacioneve mbi projektin, grupi i hartimit të VNM-së ka shfrytëzuar informacione nga website të ndryshme si dhe literatura.

Gjatë hartimit të këtij raporti VNM, është garantuar një proces i hapur konsultimesh me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit të cilët janë përfshirë nëpërmjet mundësisë që ju krijua për të dhënë mendimet dhe sygjerimet e tyre.

-Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

Procedura e thelluar e VNM-se u zhvillua sipas fazave të percaktuara në VKM nr. 686 datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" duke ndjekur këto faza të njëpasnjëshme :

- Njoftimin e AKM-se nga zhvilluesi për synimin e zhvillimit të projektit shoqëruar me të dhenat për projektin, planimetritë, harta, fotografi etj
- Konsultimin e AKM-se me institucionet e tjera të NJQV , publikun dhe OJF-te për çështjet që ato kerkuan të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-se
- Komunikimin që AKM-ja i bëri zhvilluesit për çështjet që ajo dhe palet e konsultuara kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-se
- Hartimin e raportit të thelluar të VNM-se dhe degjесen me publikun

- Një përshkrim të vështirësive (mangësive teknike ose të njohurive) që zhvilluesi ka hasur gjatë hartimit të informacionit të kërkuar.

Gjatë hartimit të informacionit të kërkuar shoqëria nuk hasi në ndonjë pengesë apo vështirësi.

3 PËSHKRIMI I PROJEKTIT DHE I VENDODHJES SE TIJ

Ky projekt ka si qëllim kryesor vlerësimin e ndikimit në mjedis të aktivitetit të shfrytëzimit të mineralit të kuarcit në objektin "Dukagjin", njësi administrative Darjan, Rrethi Mat, Qarku Diber.

Shoqëria "KUMEGA" Sh.p.k. është e regjistruar në Q.K.B. me datë 25.01.1995, NIPT - i J68118904D. Ka filluar aktivitetin e shfrytëzimit të mineralit të kuarcit në objektin "Dukagjin" me lejen minerare të shfrytëzimit nr.126 dt. 11/01/1995. Gjatë periudhës të zotërimit të lejes së shfrytëzimit kjo shoqëri ka investuar për zhvillimin e këtij aktiviteti në rrugë, makineri e pajisje, ndërtesa etj, duke rritur nga viti në vit grafiket e prodhimit dhe investimet. Shoqëria drejtohet nga një staf i specializuar dhe me përvojë të gjatë në punë.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

b) planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen, në hartë topografike, sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, të shoqëruar me koordinatat sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE, të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo instalimit të pajisjeve;

Objekti i kuarcit për të cilin është hartuar VNM –ja e Thelluar në të cilën do të bëhet shfrytëzimi i mineralit të kuarcit, ndodhet në objektin Dukagjin " Njesia administrative Darjan, Rrethi Mat .

Qendra me e afert e banuar është fshati Darjan dhe qyteti i Burrelit, rreth 30 km në perëndim të saj. Sipërfaqja e zones minerare bën pjesë në planshtetën K- 34- 77- C- c të shkallës 1 : 25 000

Sipërfaqja e Lejes minerare me kordinatat e zgjeruara prej 0.052 km^2 është në tabelën e më poshteme:


Nr.	Y	X
1	44 22 728	46 18 700
2	44 22 800	46 18 900
3	44 22 730	46 19 100
4	44 22 722	46 19 154
5	44 22 816	46 19 154
6	44 22 830	46 19 100
7	44 22 900	46 18 990
8	44 22 900	46 18 790
9	44 22 824	46 18 700
Sipërfaqja 0.052 km^2		

Sipërfaqja e zones së kërkuar për shfrytëzim është 0.052 km^2 .





44



44

3.1 PËRSHKRIMIN E PROCESVEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE / PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT;

a) Përshkrim i sistemit të shfrytëzimit që do të aplikohet.

Edhe në vendburimet e kuarceve aplikohen ato sisteme shfrytëzimi që përdoren në vendburimet e mineraleve të tjera duke marrë parasysh:

- Kushtet tekniko-minerare të objektit
- Menyra e ngarkimit, transporti dhe depozitimit të sterilizimit
- Menyra e kryerjes së punimeve të zbulimit

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te bllqeve te gelqerorit te mermerizuar ne brendesi te karrieres dhe jashte saj
- Mjetet e ngarkimit dhe transportit qe parashikohen te perdoren ne zbulim dhe prodhimin e bllqeve
- Menyren e rrezimit dhe shkeputjes se bllqeve

Nder kushtet gjoelogo – minerare rendesi ka:

- Karakteri i carjeve, Carjet e shumta te rregullta jane pengese serioze ne nxjerrjen e bllqeve.
- Prania ose mungesa e nderfutjeve te forta ose te buta, ul ne menyre te konsiderueshme rendimentin.

Nder faktoret e tjere rendesi ka:

- Kushtet klimaterike
- Distance nga konsumatoret etj.

Ne krahasimin tekniko – ekonomik te sistemit te shfrytezimit eshte marre ne konsiderate edhe mundesia e perdorimit dhe perpunimit te mbetjeve teknologjike. Tregu i shitjes dhe kerkesat e tij jane faktore qe percaktojne rradhen e pergatitjes, prodhimin ditor, mujor, vjetor etj-

Çdo sistem shfrytezimi qe aplikohet ne nxjerrjen e mermereve dallohet nga:

- lartesia e shkalles,
- gjeresia e sheshit te punes,
- gjatesia e vijes dhe drejtimi i levizjes se ballit,
- vellimi dhe karakteri i punimeve pergatitore.

Sistemi i zgjedhur siguron;

- Rendiment te larte ne pune
- kosto minimale te nxjerrjes se mineralit
- siguri ne pune

Sistemi i shfrytezimit, percakton:

- Drejtimin e shfrytezimit
- Rradhen e pergatitjes
- Punimet e nxjerrjes
- Mjetet qe do te perdoren per prodhimin e kuarcit, etj.

Per shfrytezimin e ketij objekti do te merret parasysh shfrytezimi me karriere (siperfaqe).

Sistemi i shfrytezimit ne siperfaqe duhet te plotesoje ne vellim, nxjerrjen e mineralit ne perputhje me planin, cilesine, rendiment te larte si leverdi ekonomike.

Sistemi i pranuar i shfrytezimit ne siperfaqe percakton tipin e paisjeve te transportit, paisjet e ngarkimit, permasat e karrieres, si dhe treguesit tekniko – ekonomike te tyre.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Ne shfrytezimin ne siperfaqe perdoren sisteme shfrytezimi me efektivitet te larte, organizohet puna sipas nje grafiku ciklik, arrihet prodhuesmeri e larte brenda nje kohe te shkurter dhe me kosto te vogel.

Shfrytezimi ne siperfaqe ka per detyre vendosjen e lidhjes per transportin e materialit nga horizontet e punes ne kariere deri ne sheshin e depozitimit. Horizontet e punes ne kariere jane sheshet e punes ne shkalle ne te cilat zbatohet nxjerja e materialit te zbulimit dhe prodhimit te mineralit te kuarcit.

Lidhja e siperfaqes me horizontet e punes ne kariere (shkallet) do te behet nepermjet transheve kapitale, te cilat do te krijojne sistemin e rrugeve te transportit per komunikimin me vendburimin.

Vendosja dhe pozicioni reciprok ndermjet transheve kapitale dhe sheshit te depozitimit duhet te jete i tille qe te siguroje komunikim sa me te thjeshte , siguri ne pune dhe te kete aftesine e kerkuar te transportit .

Ne zgjedhjen e menyres se hapjes te vendburimit jane mare parasysh disa faktore nder te cilet permendim : kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike te shtrirjes se vendburimit, relievi i zones si dhe vendi i vendosjes se ndertimeve ne siperfaqe, tipet e paisjeve ngarkuese dhe transportuese, qe jane pranuar per shfrytezimin e vendburimit, sistemi i shfrytezimit te vendburimit, prodhuesmeria e karieres, vellimi i mbuleses dhe shperndarja e vellimit te mbuleses e te mbetjeve teknologjike sipas viteve te shfrytezimit .

Nder kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike rol te madh luajne elementet e shtrishmerise se vendburimit, permasat e tij , kendi i renies, vetite fiziko – mekanike, ujmbajtja e vendburimit, etj .

Relievi dhe vendosja e ndertimeve ne siperfaqe luajne nje rol te madh ne zgjedhjen e menyres se hapjes, sepse percaktojne drejtimin dhe vendin e hyrjes ne kariere .

Ne zgjedhjen e menyres se hapjes ndikon dhe lloji i transportit sepse nga ai varet pjeresia e transhese kapitale , gjatesia e saj dhe forma e trasese .

Tipi dhe modeli i eskavatorit qe do te perdoret ndikon ne menyren e hapjes sepse percakton latresine e shkalles, gjeresine e sheshit ose te bazes se poshume te transhese si dhe menyren e ngarkimit .

Nga sa me siper eshte perdorur menyra e hapjes se vendburimit me transhe te brendshme .

Hapja e vendburimit eshte bere nga perendimi ne drejtim te lindjes duke u degezuar nga rruga e darjanit te ne objekt.

Per kete eshte ndertuar degezimi qe lidhe objektin me rrugen , hapja e saj eshte bere ne formacione te buta .Kjo rruge do te sherbeje ne perspektive per hapjen e zonave te tjera me ne veri te zones se konturuar .

Siperfaqja qe do te shfrytezohet me kariere eshte 0.052 km^2 .

Shfrytezimi do te filloje nga lart poshte me shkalle me lartesi 10 m . Me kete variant , punimet pergatitore qe do te kryhen para fillimit te shfrytezimit do te sherbejne per pergatitjen e blloqeve te shfrytezimit , do te jene punime per heqjen e mbuleses .

Perpara se te filloje zbulimi ne shkallen e dhene , duhet qe te behet shpyllezimi i zones qe ndodhet brenda konturit te shfrytezimit .

Ne fillim fronti i zbulimit do te filloje duke hapur per cdo shkalle , me pare nje gjysem transhe sipas izoipsit te dhene me gjeresi minimale 20 m . Kjo gjeresi merret 20 m per te pasur shesh manovrimi per transportin e sterilit me automjete ne sheshin e depozitimit .

Avancimi i gjysem transhese do te behet duke perdorur mjete te thjeshta me lende plasese , shkaterimi i mbuleses do te behet duke shpuar bira me çekiç shpues me thellesi 2.5 m. Birat do te

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN " MAT

mbushen me lende eksplozive amonit. Ngarkimi i materialit do te behet me eskavator me zinxhire me kapacitet 2 m^3 . Transporti i sterilite eshte parashikuar te behet me komione vetshkarkues me kapacitet 15 tone.

Drejtimi i hapjes se transheve do te jete nga perendimi ne lindje deri ne kufirin e shkalles se ardheshme .

Mbasi te kete perfunduar gjysmetransheja gjate gjithe izoipsit te dhene , deri ne kufirin perfundimtar , avancohet ne drejtim terthor nga jugu ne veri per te hequr koren e prishjes e cila eshte mare 5 m thellesi per çdo shkalle .

Rezimi i sterilite ne shkalle do te behet me punime shpim plasjeje duke perdorur amonit malor . Per punimet e shpim plasjes do te perdoret çekiq shpues pneumatik 25 kg .

Kendi i punes ne shkalle eshte marre 55° kurse ai i shuarjes 45° . Ne percaktimin e kendit te pjeresise se shkalles kemi pase parasysh fortesine e shkembinjve .

Thellesia e birave ne çdo shkalle do te jete 2.7 m, diametri i tyre do te jete 42 mm, distanca mes tyre ne rresht do te jete 1.6-1.7 m ndersa nga baza e nenshkalles do te jete rreth 1.5 m .

Volumi i rezuar nga nje bire parashikohet te arrije afro 5m^3 ne masiv per bire te shpuar .

Konsumi i lendes plasese per nje bire llogaritet te jete :

- Amonit 2 kg / bire
- Kapsolla te zakonshme 1 cope / bire
- Fitol i zakonshem 3 ml / bire

Materiali i rrezuar nga lenda plasese do te grumbullohet ne nivelin baze dhe prej andej do te dergohet me automjet vetshkarkues ne sheshet e depozitimit .

Ngarkimi

Ngarkimi i mineralit dhe sterilite do te jete i mekanizuar. Ai do te behet eskavatore, ashtu siç veprohet aktualisht ne te gjitha objektet minerare siperfaqesore. Transporti do te behet me kamione vetshkarkues

Steriliti do te depozitohet ne sheshin e caktuar brenda territorit te fushes minerare. Minerali do te depozitohet perkohesisht ne sheshin e depozitimit te mineralit dhe qe aty me kamione do te transportohet per ne destinacion.

Rezervat e llogaritura

Rezervat gjeologjike te miratuara ne studimin tekniko ekonomik dhe projektin e shfrytezimit nuk ka pesuar levizje te medha pasi ky vendburim eshte i rigjenerueshem. Eshte vene re se zona e licencuar nuk eshte e gjitha me permbajtje kuarciteh. Gjate shpelarjes se kores se siperme argjilore me trashesi 0.5 – 1 m si rezultat i shirave, ka bere te mundur qe te dalin ne pah zona flishore pa permbajtje kuarci ose me permbajtje ne permasa te vogla te kuarciteve. Nisur nga fakti se ne te gjithe kete siperfaqe vetem nje zone e vogel prej 0.001 km^2 ka permbajtje te larte rezervash kuarcore dhe se eshte zona qe grumbullohen poplat dhe zajet e kuarcit, atehere ne keto 10 vitet e ardheshme eshte planifikuar qe te shfrytezohet vetem ne kete zone.

Nr	Lloji dhe kategoria e rezervave	Gjendja e rezervave në fillim të vitit raportues, 11.01.1995	Konsumi i rezervave gjatë vitit 11.01. 1995 deri 10.01. 2015		Gjendja e rezervave në fund të mbarimit te lejes minerare
			Planifikuar	Realizuar	

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

		Sasi (ton)	Cilësi (%) Cr ₂ O ₃	Sasi (ton)	Cilësi (%) Cr ₂ O ₃	Sasi (ton)	Cilësi (%) Cr ₂ O ₃	Sasi (ton)	Cilësi (%) Cr ₂ O ₃
1	A (ton)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2	B (ton)	50 000	95.00	40 000	95.00	40 000	95.00	10 000	95.00
3	C ₁ (ton)	0.0	0.00	0.0	0.00	0.0	0.00	0.0	0.00
4	C ₂ (ton)	0.0	0.00	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Total , nga keto	50 000	95.00	40 000	95.00	40 000	95.00	10 000	95.00
a	Te pergatitura (ton)	0.0	0.00						
b	Te gateshme (ton)	7000	95.00					10 000	95.00

Grafiku i zhvillimit te punimeve

Gjate viteve ne vazhdim, per periudhen 10 vjeçare eshte planifikuar prodhimi i kuarcit prej 20 000 ton ose 2000 ton ne vit. Kjo sasi minerali kuarci prej 2000 ton/ vit do te prodhohet duke shfrytezuar siperfaqen jo me te madhe se 0.001 km². Ne kete siperfaqe eshte perqendruar pjesa me e madhe e rezervave gjeologjike. Ndersa pjesa tjeter e mbetur e zones se licencuar nuk ka interes per tu shfrytezuar sepse rezervat gjeologjike jane shfrytezuar gjate viteve 1995 – 2015, dhe rigjenerimi i rezervave ne kete siperfaqe eshte i ulet.

Prodhimi i kuarcit do te do te realizohet midis profileve 6 – 6.

Prodhimi ne kete profil do te realizohet ne shkallet :

Profili 6 – 6 shkalla +660 deri + 665 dhe + 665 deri +704

Blloku nr.1 midis profilit 7 – 7 dhe profilit 6 – 6

Drejtimi i shfrytezimit do te jete veriperendim – juglindje. Drejtimi i shfrytezimit brenda bllokut do te jete jugperendim – verilindje.

Shfrytezimi gjate ketij viti do te kryhet kryesisht duke seleksionuar poplat dhe zajet e kuarcit me dore por do te kete nevojë dhe per ndihmen e eskavatorit per germim dhe per shkrifetim. Eskavatori me ndihmen e koves leviz ne vend masen minerare dhe me ndihmen e punetoreve behet seleksionimi dhe grumbullimi i kuarcit ne pika te veçanta ne karriere.

3.2 INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACION PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA

Furnizimi me energji elektrike

Ne objekt punet e shfrytezimit te mineralit te kuarcit do te behen me mekanizma qe punojne me nafte , keshu qe nuk do te perdoret energji elektrike.

Lidhja telefonike do te jete mobile.

Depozitimi i sterilit dhe mineralit

Llogaritja e kapacitetit depozitues eshte bere per nje sasi jo te madhe rezervash per faktin se prodhimi i mineralit te kuarcit parashikohet qe te transportohet direkt nga fronti i prodhimit per ne destinacion.

Sheshi i depozitimit te mbuleses eshte parashikuar te jete brenda karrieres ne vende te veçanta. Nje pjese e ketyre sterileve do te perdoret per rehabilitimin e rruges automobilistike.

3.3 PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT

Ne studimin tekniko - ekonomik dhe projektin e shfrytezimit te ketij objekti eshte programuar qe punimet e ndertimit te objekteve si rruge, vendosja e konteniereve etj.. te kryhet vitin e para te zhvillimit te kesaj veprimtarie ose gjate vitit 2018. Bazuar ne Ligjin Minerar afati i vlefshmerise per fazen fillestare te zhvillimit te ketij aktiviteti do te jete 10 vite ose 2018 - 2028. Thelluarisht mendohet qe perfundimi i funksionimit te ketij aktiviteti te jete viti 2028. Me mbylljen e ketij aktiviteti fillon faza e rehabilitimit te ketij objekti mbi bazen e nje projekti mbylljeje rehabilitimi dhe monitorimi ne perputhje me kerkesat e Legjislacionit ne fuqi.

3.4 MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË PROJEKTIT

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Siç theksuam me sipër objekte të këtij projekti janë hapja e rruges, vendosja e kontenierit etj. të cilat do të instalohen vitin e parë të fillimit të punimeve mbi bazën e projekteve specifike që do të hartohen për këtë qëllim, ndërsa në fazën e shfrytëzimit është përcaktuar si mënyrë shfrytëzimi ajo me sipërfaqe duke kryer llogaritjen e shpenzimeve që kryhen për nxjerrjen e 1 ton mineral kuarci me shfrytëzim sipërfaqësor dhe shfrytëzim nëntokesor, nga ku ka rezultuar që shpenzimet e shfrytëzimit me sipërfaqe janë shumë më të vogla ose të pakrahueshme me shfrytëzimin nëntokesor.

Ndërsa zyrat dhe ambientet e tjera si gardërob, fjetore, mence, magazine, materialesh, ofiçina dhe garazhi i automjeteve do të instalohen në afërsi të qytetit të Burelit.

3.5 LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI)

Siç u trajtua më lart në këtë objekt nuk do të ndërtohen objekte sipërfaqësore e për rrjedhojë nuk lind nevoja për përdorimin e materialeve të ndërtimit. Lende e parë kryesore që do të përdoret është nafta që do të përdoret nga makineritë (eskavatori).

3.6 INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH /PRANË ZONËS SË PROJEKTIT

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk lidhet me projekte të tjera ekzistuese në zonë dhe përreth saj.

3.7 INFORMACION LIDHUR ME ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATË PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET;

Alternativat e marra në konsideratë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij objekti hollesisht janë trajtuar në studimin tekniko - ekonomik dhe projektin e shfrytëzimit. Për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes, ajo është e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe shpallur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë si zonë shfrytëzimi pas konsultimeve me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë, Pushtetin Vendor etj. dhe fituar nga Shoqëria "KUMEGA" Sh.p.k.

Teknologjia që do të përdoret është i thjeshtë, me anë të eskavatorit do të bëhet gërmimi dhe shkriferimi i masës së mineralit dhe pastaj me anë të punetoreve do të bëhet seleksionimi dhe grumbullimi i mineralit të kuarcit në vende të veçanta të karrierës. Që atëherë me anë të kamioneve do të transportohet për në destinacion (në uzinat e ferokromit që operojnë në vendin tonë).

Organizimi dhe fuqia punetore

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Ne kushtet gjeografike dhe klimaterike ku ndodhet karriera , shfrytezimi i mineralit se bashku me punimet e tjera pergatitore (transhe ,rruge dhe zbulim) parashikohet te zgjate 10 vjet . Ne te per kushte optimale pune per kapacitetin vjetor parshikohet te punojne:

Nr	Personel	Persona
1	Drejtues teknik ing minere	1
2	Teknik miniere	1
3	Eskavatorist	1
4	Seleksionues	5
5	Roje objekti	1
6	Shofere	1
	Shuma	7

Regjimi i punes do te jete me nje nderese ne dite dhe 22-25 dite ne muaj. Paga mesatare parashikohet 30 000 leke/muaj. Siç e kemi theksuar edhe me siper, fuqia punetore do te jete ajo egzistuese, ndersa nevojat e reja do te plotesohen nga zonat e banuara ne afersi te vendburimit qe ka mjaft specialiste te afte per profesionet e kerkuara. Pra nuk do te jete problem sigurimi i fuqise punetore per kete subjekt.

Sigurimi teknik

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar Subjekti duhet te mbaje parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

Drejtuesi teknik i punimeve, para fillimit te punes dhe gjate saj, do te zbatoje rregullat dhe normat e percaktuara ne Regulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karierat qe jane ne zbatim dhe Ligjit Minerar te Shqiperise Nr 10304, date 15.7.2010 dhe akteve nenligjore te tij. Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit privat, do te zbatohen ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes,i cili duhet te permbaje:

- Plan organizimi i punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve
- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik dhe azhurnimin e sakte te punimeve minerare te cdo lloji per te cilat subjekti ka marre leje shfrytezimi
- Rradha e kryerjes se punimeve do te percaktohet hollesisht ne planin e masave tekniko-organizative dhe do te miratohet nga pronari i firmes
- Ne kete plan tekniko-organizativ, masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruktive te rregullta mujore e tre mujore , ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet
- Punonjesit, qe do te punojne ne karriere per kontrollin e shpateve te shkalleve, shesheve te ngarkimit , rrugeve te transportit etj do te instruktohen rregullisht dhe do te ndjekin me rigorozitet zbatimin e rregullave dhr normave te Rr.T.S., qe lidhen me keto probleme
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te pune, pastrimit te shesheve te shkalleve rrugeve te transportit, krefjes dhe skarifikimit te shpateve te shkalleve te punes dhe nenshkalleve sidomos kur punohet ne zonen me shkembinj me çarje.
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve te ngarkimit dhe transportit te brendshem.

3.8 PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE

Gjate funksionimit te ketij objekti si lende e pare kryesore do te jete lenda djezese (nafta) qe do te perdoret nga eskavatori dhe kamioni.

3.9 AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCAVE ETJ.; INFORMACION PËR LEJET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, TË KËRKUARA NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT.

Gjate zbatimit te projektit nuk do te linde nevoja per ndërtim te kampeve apo rezidencave. Zyrat dhe ambjentet e tjera si garderob, fjetore, mence, magazine, materialesh, ofiçina dhe garazhi i automjetevedo te instalohen ne afersi te qytetit te Burelit.

Lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi do te jene :

- Leja e shfrytezimit e leshuar nga Ministria e Energjise dhe Industrise dhe Q.K.L. me afat 10 vjet .

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

-
- 4 NJË PËRSHKRIM I ANALIZIMIT TË ALTERNATIVAVE TË MUNDSHME PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT OSE KOMPONENTËVE TË VEÇANTA TË TIJ (SI: AKSESI RRUGOR, ADMINISTRIMI I MBETJEVE DHE UJËRAVE TË NDOTURA, LLOJET E LËNDËVE DJEGËSE, VENDNDODHJA E PROJEKTIT ETJ.), SI DHE SQARIMI I ARSYEVE KRYESORE PËR ALTERNATIVËN E PROPOZUAR, DUKE MARRË PARASYSH NDIKIMET NË MJEDIS TË SECILËS ALTERNATIVË, SI DHE, PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT.**

Alternativat e mundshme për zbatimin e projektit ose komponentëve të veçanta të tij (si: aksesi rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse, vendndodhja e projektit etj.), siç është trajtuar dhe në studimin tekniko - ekonomik dhe projektin e shfrytëzimit janë me sipërfaqe. Në këtë rast ndikimet në mjedis përpara i takon aksesit rrugor, administrimit të mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojeve të lëndëve djegëse janë afërsisht të njëjta. Nisur nga krahasimi tekniko - ekonomik, kushtet e punës, sigurimi i jetesë së punonjësve etj. është zgjedhur si alternativa më e mirë ajo e shfrytëzimit me sipërfaqe (kariere)

PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT

4.1 HIDROGRAFIA, HIDROGJEOLOGJIA

Nga pikpamja hidrografike, objekti nuk ka brenda kufijve të tij perrenj të ndryshëm ose vija ujëndarëse të cilat mund të ndikohen nga shfrytëzimi i tij . Shfrytëzimi rruan drejtimin e përgjithshëm të rrjedhës së ujërave të rreshjeve.

4.2 DEMOGRAFIA, INFRASTRUKTURA EKZISTUESE

Zona ku ndodhet objekti " DUKAGJIN" për shfrytëzimin e mineralit të kuarcit merret kryesisht me, bujqësi dhe blegtori, kjo zonë kryesisht në bujqësi kultivon kulturë bujqësore tradicionale, si miser dhe foragjere për bageti. Tani kanë filluar të kultivojnë edhe kulturë të vonshme.

Një përhapje të gjërë kanë marrë punimet në fushën e bujqësisë për kanalizime të ndryshme. Popullsia e kësaj zone i përket një zone rurale dhe merret kryesisht me punë bujqësore dhe blegtorale si dhe një pjesë e tyre në emigracion dhe në aktivitetë të tjera pak të rëndësishme. Ata banojnë në fshatrat. Popullsia e përgjithshme e këtyre fshatrave shkon në rreth 1200 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, blegtori. Një pjesë jo e vogël e krahut të lirë punës vazhdon prej vitesh në emigracion (kryesisht Greqi e Itali). Një pjesë e mirë e fuqisë puntore angazhohet në fushën e ndërtimit.

4.3 INFRASTRUKTURA EKZISTUESE

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI “ DUKAGJIN” MAT

Siç tham vendburimi i mineralit të kuarcit në Dukagjin Rrethi Mat ndodhet rreth 30 km në Veri Lindje të qytetit të Burrelit ku ka filluar shfrytëzimi.

Nga fshati Darjan deri afër objektit është hapur rruga me tregues të mirë me taban të fortë me gjërsi 4.5 m e cila ka nevojë për riparime pas periudhës së dimrit.

Vendburimi i kuarcit ndodhet në luginën e perroit të Stoinave dhe shfrytëzimi i tij ka favorizim, mbasi germimi dhe levizja e materialit steril dhe mineralit të kuarcit nga sheshi i shfrytëzimit bëhet me eskavator.

4.4 EKONOMIA E ZONËS DHE AKTIVITETET KRYESORE

Ekonomia e kësaj zone është përgjithësisht ekonomi rurale që i përket punëve bujqësore e blegtorale, frutikultures, tregëtisë së vogël, etjere.

Hapja dhe zhvillimi i karrierave të prodhimit të mineralit të kuarcit në këtë objekt do të ndikonte në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin dhe përmirësimin e ekonomisë së fshatrave përreth, për këtë arsye këto aktivitete duhen stimuluar.

Ky aktivitet do të krijojë një burim të ri të ardhurash për banorët dhe të fshatrave përreth.

4.5 MJEDISI BIOLOGJIK

4.5.1 ZONAT E MBROJTURA

Në afërsi të këtij rajoni të propozuar nuk ka ndonjë zonë të mbrojtur.

Statusi i zonës

Territori në studim nuk është i përfshirë në mënyrë të drejtperdrejtë si zonë e mbrojtur si:

- a) rezerve strikte natyrore\ rezervat shkencor\ (Kategoria I);
- b) park kombëtar (Kategoria II);
- c) monument natyror (kategoria III);
- ç) rezervat natyror i menaxhuar\ zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);
- d) peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- dh) zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara\ zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

Zona ku do zhvillojë projektin **Subjekti “KUMEGA” Sh.p.k** nuk është i përfshirë në zonë buferike, të cilat ruhen në përputhje me legjislacionin e Mjedisit në fuqi dhe në përputhje me politikat dhe planet që aplikon Ministria e Mjedisit.



Harta e zonave te mbrojtura.

Kjo zone nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me interes nderkombetar, ku mund te permendim konventen e Ramsarit, konventa boterore e trashgimise,etj.

Raporti identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive dhe ato negative dhe percakton "rezultate te pergjithshme" per secilen prej tyre. Raporti Thelluar i Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejtperdrejta.

4.5.2 NJË PËRSHKRIM TË GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TË MJEDISIT, QË MUND TË NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR, DUKE PËRFSHIRË

4.5.3 PËRSHKRIMIN E KARAKTERISTIKAVE FIZIKE TË ZONËS SË PROJEKTIT

- Përshkrim të faktorëve klimatikë;

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Si ne te gjithë pellgun e Burrelit, ne kete zone kemi te bejme me nje klime kontinentale, me vere te nxehte e te thate e dimrit te ftohte. Periudha e dimrit shoqerohet me rreshje te shiut dhe debores . Rreshjet e bores fillojne ne muajin Nentor dhe deri ne fund te muajit Mars ne pergjithesi rruget bllokohen. Rreshjet e debore zakonisht e kalojne trashesine 1.5-2m, sidomos mbi lartesine 1000 m. Muajt Janar dhe Shkurt vleresohen si muajt me te ftohte te vitit ku jane regjistruar temperatura deri – 25° deri -30 °. Ne kete periudhe jane te shpeshta dhe bllokimet e rrugeve automobilistike si nga ngricat ashtu dhe nga debora . Per kete shkak levizja e punetoreve per ne sektor veshitohet pasi udhetojne ne kembe.

Periudha 15 Qershor deri 20 Gusht , vleresohet si periudha me e nxehte dhe me e thate e vitit , me sasi te vogla shiu . temperaturat maksimale te regjistruara ne kete periudhe i kane kaluar 38 ° C . Zona eshte gjithmone nen ndikimin e ererave qe fryjne ne drejtim Veri – Lindje , Jug – Perendim .

- Përshkrim gjeomorfologjik dhe të sizmicitetit të zonës së projektit;

Sizmiciteti

Mjedisi i ndërlikuar strukturor i Shqipërisë i përket Rajonit të Mesdheut qendror ku pllakat kontinentale të Afrikës dhe të Evropës përplasen duke krijuar disa breza aktivë sizmikë. Në veçanti, Shqipëria ndodhet në vendtakimin midis mikropllakës së Adriatikut dhe pllakës Euroaziatike dhe karakterizohet nga një veprimtari e fortë e mikro-tërmeteve dhe nga tërmete të madhësive të vogla dhe të mesme dhe vetëm rrallë nga tërmete të forta. Ne baze te rajonizimit sizmik te sipërfaqes se Shqiperise zona e studimit tone perfshihet ne zonen sizmike me intensitet 7 ballë, sipas shkalles MKS (viti 1964) dhe magnitude 5-5,5.

- Përshkrim të gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit;

Nga studimi gjeologjik i kryer ne objektin qe kerkojme per licencim (qe quhet perroi i Stoinave) qe ndodhet ne fshatin Dukagjin te rrethit Mat, rezulton se formacionet gjeologjike ne kete objekt jane inertet aluvjale e proluvjale qe ndodhen ne shtratin e perroit. Per permbajtje te larte te zajeve e poplave te kuarcit. Thellesia e shfrytezimit eshte merre sipas trashesise se inerteve ne profile. Kjo trashesi shfrytezimi eshte e domosdoshme per prodhimin e mineralit te kuarcit qe parashikohet te shfrytezohet duke mare parasysh dhe prurjet vjetore te lumit te cilat rigjenerojne depozitimet e shtratit te perroit me material inertesh kuarci.

Rajoni i objektit te kuarciteve ne inertet lumore te perroit te Stoinave, ndertohet nga depozitimet litologo – faciale te zones strukture te Mirdites dhe paraqitet njafi e komplikuar. Konkretisht takohen :

- **Shkembjenjte intruzive J₂ – J₃** te perfaqesuar nga ultrabaziket me te gjitha llojet e tyre, si dunitet, peridotitet, serpentinitet dhe serite damarore qe ndertojne kornizen e gropes se Burrelit dhe dalin ne lindje te objektit.
- **Kreta e poshtme Cr₁** e perfaqesuar nga konglomerate bazale, takohen ne lindje te objektit.
- **Kreta e sipërme Cr₂** e perfaqesuar nga gelqerore rudiste qe perhapen ne veri dhe ne lindje te objektit duke bere pjese ne kornizen e gropes se Burrelit.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- **Depozitimet neogjenike** te perfaqesuara nga depozitimet terrigjene te Tortonianit te poshtem dhe te siperm (N_1t_1 dhe N_2t_2)
 - Tortoniani perbehet nga dy suita :
 - a-**Suita e poshteme** N_1t_1 qe vendoset transgresivisht mbi depozitimet me te vjetra dhe perfaqesohet nga konglomerate me zaje te dimensioneve te ndryshme 20 – 50 mm deri ne 200 – 300 mm, ranore dhe rralle argjila. Zajet perfaqesohen nga kuarci, gabroefuzivet, shiste argjilore dhe rralle ultrabazike. Trashesia luhetet nga 50 m deri ne 200 – 300 m.
 - b- **Suita e siperm** N_1t_2 , qe perfaqesohet nga nderthurje argjilore – ranore e me rralle me ndonje shtrese konglomeratesh. Trashesia shkon 500 – 700 m.
 - Tortoniani i siperm perfaqesohet nga konglomerate qe kane formen e shtresave te rregullta e me rralle ne forme linzore. Takohen ranor e argjila. Trashesia shkon 200 – 300m.
 - Kuaternari Q – perfaqesohet nga depozitimet e vjetra aluvjonale (Q2) qe perhapen kryesisht ne luginen afer objektit. Depozitimet e reja Q3 – Q4 te perfaqesuara nga formime aluvjale e deluvjale ne rrezat e shpateve te kodrinave dhe te shtratit te perroit te Stoinave. Depozitimet aluvjele te shtratit te perroit kane permbajtje te konsiderueshme te zajeve te kuarcit te cilat perbejne objektin mineralmbajtes te grupit te dyte, te klasifikuar sipas ligjit minerar. Ata perbehen nga popla me madhesi rreth 200 – 300 mm, nga zaje ku madhesia e zajeve eshte 80 mm, zhavore me madhesi te zajeve 5 – 20 mm dhe rere me madhesi te grimcave nen 5 mm. Ne objektin e kerkuar depozitimet kane gjeresi nga 50 – 100 m deri ne 150m. Thellesia luhetet nga 1 – 5 m dhe ndofta dhe me shume. Perberja minerale eshte e ndryshme pasi dhe depozitimet qe shtrati i perroit mbart ose vjell gjate vitit jane te ndryshme, siç jane depozitime kuarcite, gelqerore, ultrabazike, efuzive. Pervec depozitimeve aluvjale ne kete zone ose rreth saj ka dhe depozitime tarracore (kompleksi ranoro – konglomeratik) me trashesi 50-100-150m. Nga ana litologjike tarracat perbehen nga zajet e kuarcit, zaje efuzivesh gelqeroresh, ultrabazikesh, shista argjiloresh te çimentuara nga meteriali argjilor. Permasat e zajeve variojne nga 2 mm deri ne 200 mm. Me perjashtim te ndonje pjese fare te vogel me mbulesa argjilore – ranore qe nuk i kalon 20 – 30 cm.
- Theksojme se edhe pjeset anesore te shpateve te perroit si dhe kompleksi tarracor perbejne objekt te mire shfrytezimi por qe i perket te ardhmes.
- Zona qe do te shfrytezohet ka kuarcite kryesisht me permbajtje te SiO_2 mbi 93% por mund te arrije deri ne 99% SiO_2 .
- Pesha volumore e kuarcit eshte 2.644 gr/ cm^3 .
- Fortesia e kuarcit sipas shkalles se Mohsit eshte 7

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

- Përshkrim të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Ujrat nëntokësore, që përmbajnë trupat xeherore dhe shkembijte rrethues, janë të çarjeve dhe si rrjedhim këne një shpërndarje jo të njëtrajtshme.

Prurjet e ujit që ushqehen nga ujrat sipërfaqësore janë në varesi të thellesisë së punimeve dhe janë me të mëdha në kohë me rreshje dhe gjatë shkrirjes së deborës .

Perberja e ujit varet kryesisht nga shplarja e ultrabazikeve si dhe të pjesëve të shkateruara, dhe tipi predominues i tyre është ai i tipit hidrokarbonat magneziumi me mineralizim të përgjithshëm 0.30 – 0.40 gr/l. Reaksioni i ujit është bazik me PH = 8.2 dhe fortësia e ujit është 9.5-11⁰ gjermane.

Zona e Darjanit , brenda së cilës përfshihet dhe objekti "Dukagjin", është një me përmbajtje të ulet të ujërave

Prania e ujërave të rreshjeve të shiut nuk veshitësojnë kushtet teknike të shfrytëzimit të objektit pasi ato mund të rrjedhin në drejtim të shpatit të kodres si dhe përgjatë rrugës që do të zhvillohet për lidhje të objektit me atë e kuzistuese .

Rreshjet e deborës do të veshitësojnë kryesisht transportin e materialit të prodhuar në karriere, i cili, për arsye të tyre, mund të nderpritet për intervale të kufizuar kohe.

Sic u përmend më sipër vendburimi gjeografikisht përfaqëson një strukturë monoklinale në formën e një shpati plotësisht të drenuar dhe nuk ka përmbajtje ujërash në të, me përjashtim të ndonjë sasi të vogël në kuotat e poshteme që vjen nga perroi i Stoinave.

Nga pikpamja hidrogafike, objekti nuk ka brenda kufijve të tij perrenj të ndryshëm ose vija ujëndarëse të cilat mund të ndikohen nga shfrytëzimi i tij. Shfrytëzimi ruan drejtimin e përgjithshëm të rrjedhës së ujërave të rreshjeve.

4.5.4 PËRSHKRIMIN E BIODIVERSITETIT NË ZONËN E PROJEKTIT

- Përshkrim të vegjetacionit në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre;

Për nga origjina, perberja dhe veçoritë gjeobotanike, bimesia e vendit tonë bën pjesë në zonën floristike mesdhetare. Adaptimi i bimeve në zone ndaj thatësirës dhe terrenit shkëmbor janë rrenjet e tyre të shtrira shumë thelle që bëjnë të mundur thithjen e çdo pike uji që ka shtresa e thelle e truallit.

Sipas shtrirjes vertikale të bimesisë objekti që studiohet ndodhet në zonën e shkurreve mesdhetare. Kufiri i sipërm i kesaj zone ngrihet në mënyrë graduale nga veriu me lartësi + 400 m, në



- Përshkrimin e faunës në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre;

Nder elementet e mjedisit natyror rendesi te veçante per rritjen dhe perhapjen gjeografike te kafsheve te egra ka klima, bimesia, pasurite ujore dhe relievi. Klima ne teresine e saj mesdhetare eshte e larmishme ku ngricat dhe rreshjet e bores ne zonen qe studiohet nuk jane dukuri te zakonshme. Ne secilen prej mikroklimeve gjenden kafshe karakteristike qe jane pershtatur sa me mire me te.

Edhe ujrato luajne rol te rendesishem ne jeten dhe perhapjen e kafsheve. Ne zona gelqeroresh karstik me rrjet hidrografik siperfaqesor shume te varfer sic eshte rasti i objektit qe studiohet. Ne raste te tilla kafshe te egra jane te detyruara te bejne migracion ditor ne kerkim te ujit te pijshem.

Bimesia eshte elementi kryesor i natyres qe u siguron kafsheve te egra strehim dhe atyre barngrenese ushqim.

Relievi i përbërë nga kodra e zona malore të ndërthurura me një rrjet hidrografik të pasur i jep mundësi zonës të mbështesë zhvillimin e faunës së egër.

Gjitaret

Dhelpra (vulpes, vulpes, L) ne saje te aftesive per te pergjuar e maskuar ajo u afrohet shume qendrave te banuara fshatare ne kerkim te ushqimit. Ajo eshte e perhapur ne te gjithe vendin dhe ne te gjithe lartesite.

Ujku eshte shume i zhvilluar ne kete zone ku perfshihet dhe objekti i marre ne studim.

Shqarshi (kunadhja) (martes foino, L) eshte kafshe e vogel mishngrenese me gezof te cmueshem.

Ushqehet me shpende, veze etj. eshte e perhapur ne te gjithe vendin dhe zonen qe studiohet. Preferon zonat karstike ku fshihet ne guva e shpella.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Shqarshi (kunadhja) (martes foino, L) është kafshe e vogël mishngrenese me gezof të cmueshem. Ushqehet me shpende, veze etj. është e përhapur në të gjithë vendin dhe zonën që studiohet. Preferon zonat karstike ku fshihet në guva e shpella.

Shpendet (ornitofauna)

Thellenza e malit jeton në vise malore pavarësisht nga lartësia e terrenit. Në verë zbrit në perrenj në kërkim të ujit të pijshëm. Është mjeshtrë e maskimit dhe e mashtrimit të armiqve të saj.

Zvarraniket (reptile)

Bota e zvarranikeve e vendit është shumë e përhapur dhe mjaft e pasur me lloje të ekzemplare. Ato takohen në të gjithë mjedisin. Përhapjen më të madhe kanë gjarpërinjtë e hardhucat. Gjarpërinjtë janë të shumëllojshëm. Përhapje të gjera kanë ato helmues (shigjeta). Me helmues dhe i rrezikshëm është neperka e zakonshme. Shumë të përhapura janë hardhucat.

- Përshkrimin e zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti, përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

"Zona të mbrojtura" shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe të tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona në të cilën do të zhvillohet aktiviteti i shfrytëzimit të mineralit të kuarcit nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MM.

5 PËRSHKRIMIN E CILËSISË SË MJEDISIT DHE NDIKIMEVE EKZISTUESE

- Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Nga studimet e ndryshme hidrometereologjike te kryera ne zone si dhe nga te dhenat e marra nga objektet qe jane ne shfrytezim ne afersi te kesaj zone, arrijme ne perfundimin : *kushtet hidrogeologjike te objektit jane te thjeshta me permbajtje te pakta ujerash nentokesore, kryesisht te çarjeve te tipit hidrokarbonatik me PH 6,5-7 dhe mineralizim 0,35 gr/liter.*

- Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;

Në punimet minerare ajri pëson ndryshim presioni, temperature, lagështirë relative, ul përmbajtjen e oksigjenit dhe ngopet me gazra toksik si CO, CO₂, SO₂, CH₄, NO, NO₂, H₂S, H₂, ngopet me pluhura etj. Ajri eshte nje perzierje gazesh te azotit (78%), oksigjenit (21%), dioksidit te karbonit (CO₂) dhe te disa gazeve te tjere inerte. Ai, gjithashtu, permban avuj uji, sasia e te cilave ndryshon sipas gjerese gjecografike te zones, afersise se saj me siperfaqet ujore etj. Ajri permban dhe nje numer substancash te demshme.

Ndotja e ajrit kryesisht vjen nga trafiku i madh i makinave ne transportin rrugor qe eshte burim i rendesishem per leshimin e substancave te demshme ne ajer, siç jane: plumbi, benzeni, grimcat e imta dhe benzopireni. Pasojat jane paraqitja e smogut dhe koncentratet e shtuara te ketyre substancave ne ajer. Transporti rrugor shkakton, gjithashtu, me shume se gjysmen e shkarkimeve te NO_x dhe 35% te shkarkimeve organike te avullueshme Automjetet me motor naftë prodhojne grimca shume te imta, te cilat jane shume te demshme per shendetin e njeriut.

Ndotja e ajrit shkaktohet edhe nga industria e cila ne zonen e projektuar per shfrytezim dhe rajon nuk ekziston.

Burimi kryesor i çlirimeve të substancave acide në mjedis janë emetimet e gazta, që përmbajnë dyoksid sulfuri SO₂, okside të azotit NO_x dhe amoniak NH₃. Këto gaze krijohen gjatë djegies së substancave organike të djegshme në sektorët e shërbimeve, transportit, prodhimit të energjisë, industrisë kimike dhe metalurgjike etj. Pas çlirimit në atmosferë, këto gaze shpërndahen në hapësirë dhe mund të qëndrojnë për disa kohë në gjendje të shpërhapur.

Gazet SO₂, NO_x, dhe NH₃ bien direkt në sipërfaqen e tokës dhe vendosen në bimësi dhe elementë të tjerë mjedisorë ose bien në gjendje të lagësht së bashku me borën, shiun, mjegullën etj. Këto gaze (si rezultat i zhvillimit të disa reaksioneve kimike) shndërrohen në acide squfuri dhe azoti kur ato qëndrojnë në atmosferë, si edhe kur bien në tokë. Ligji Nr. 8934, i datës 5 Shtator 2002 mbi Mbrojtjen e Mjedisit siguron për adoptimin e programeve të kontrollit të ndotjes në Shqipëri, megjithatë për zonën në vleresim nuk ka të dhëna te publikuara mbi cilësinë ekzistuese të ajrit të lidhura me çlirimin e SO₂ ose NH₃. Te dhena te monitorimit per zonen e zbatimit te projektit nuk disponohen pasi konsiderohet si nje zone pa aktivitete ndotese. Cilesia e ajrit ne zonat malore te vendit te cilat ndodhen larg zonave urbane dhe industrise se rende, eshte brenda normave te cilesise se nje ajri te paster.

- Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Lidhur me zhurmat, në zonën e studimit nuk ka ndonjë informacion në lidhje me nivelet e ndotjes së ambientit. Zhurma nuk është shqetësim në zonën që rrethon këto zone rurale drejtpërdrejt. Aty nuk ka burime emetimi të ndjeshëm zhurmash. Nivelet e zhurmës brenda fshatrave janë tipike për çdo zonë rurale të nivelit të fshatrave dhe janë të lidhura kryesisht me trafikun e automjeteve që është në nivel minimal por infrastruktura e dobët ndikon në rritjen e këtij niveli. Megjithatë rekomandohet që nivelet e zhurmës duhet të monitorohen gjatë ndërtimit por edhe gjatë operimit.

Zhurma në ambient gjenerohet nga ekskavatori dhe makina e transportit për kohën që ato janë në punë. Në rastin konkret këto janë të papërfillshme dhe meqenëse qendrat e banuara janë në distanca të largëta ato nuk krijojnë shqetësime tek banorët. Përsa i përket punonjësve, ato gjatë këtyre proceseve do të jenë të mbrojtur me syze, maska, kufje për të parandaluar shqetësimet e mundshme që mund të lindin gjatë ekspozimit ndaj zhurmave të pluhurave.

Punonjësit që janë të ekspozuar në zhurmë në nivelin nën 100 dB kalojnë në kontroll shëndetësor për shkallë ndigjimi çdo vitë, ndërsa për ekspozimet mbi 100 dB kontrolli bëhet çdo 6 muaj.

Për nivel zhurme mbi 85 dB aplikohet detyrimisht mbrojtje veshësh duke përdorur mjete mbrojtëse (kufje, tampona etj), ndërsa për nivel zhurme 90 dB e lart, kërkohet të merren masa mbrojtëse për reduktimin e zhurmave. Në këtë rast koha e ekspozimit në një zhurmë të tillë është e rendit të 1-2 milisekondave. Niveli i zhurmave të krijuara për rastet b dhe c është i njëjti. Rreziqe si pasojë e avarive të pajisjeve apo gjatë proceseve

Avaritë parashikohen vetëm në mekanizmat e instaluar, masat për eliminimin e tyre cilave janë trajtuar më sipër.

- Administrimi i mbetjeve në zonën ku propozohet projekti;

Projekti ka parashikuar hapjen e një sheshi për stërvitje. Në këtë shesh do të vendosen sasi të shtresës së tokës, shkëmbinj, sipas rasteve që do të hasen dhe nuk do të jenë me vlerë për transport e përpunim. Për rehabilitimin e tyre, është hartuar një raport rehabilitimi të demtimeve nga karriera.

- Probleme të tjera (nëse evidentohen), të tilla si: erozioni i tokës, zjarret, ndotje historike etj.;

Gjatë konsultimit me publikun dhe rikonjicionit të terrenit rezultoi që nuk do të ketë probleme lidhur me erozionin e tokës pasi ajo është e mbuluar me shkurrë e bimesi. Gjithashtu nuk parashikohen që në zonë të kemi shfaqjeve të zjarreve apo ndotje historike.

- Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (të tilla si: ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh etj.).

Në zonën ku zhvillohet projekti nuk do të ketë presione në mjedis përveç atyre që u trajtuan nga zhvillimi i këtij projekti

6 PËRSHKRIM I KARAKTERISTIKAVE SOCIALE TË ZONËS KU PROPOZOHEJ PROJEKTI

- Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti;

Objekti i shfrytëzimit të mineralit të kuarcit "Dukagjin" ndodhet në territorin e Rrethit Mat, Qarku Diber. Qendra më e afërt e banuar është Fshati Darjan që ndodhet rreth 2km larg në Lindje të objektit. Qendra administrative e zonës është Bashkia Burrel, Qarku i Diber ka një popullsi prej 68 000 banorë. Ai përbëhet nga Rrethi Diber, Bulqize dhe Mat, me 4 Bashki.

- Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës;

Ekonomia e kësaj zone është përgjithësisht ekonomi rurale që i përket kryesisht punëve bujqësore e blegtorale dhe frutikutures. Hapja dhe zhvillimi i karrierave të prodhimit të mineralit të kuarcit do të ndikonte në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin dhe përmirësimin e ekonomisë së fshatrave përreth, për këtë arsye këto aktivitete duhen stimuluar.

Ky aktivitet do të krijojë një burim të ri të ardhurash për banorët e komunës dhe të fshatrave përreth

7 PËRDORIMI I TOKËS NË ZONËN E PROJEKTIT

- Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane.

Parimet baze për hartimin e planit të administrimit dhe menaxhimit të mbetjeve minerare konsistojnë në :

Niveli i ndotjeve në ujë tokë, florë dhe faunë dhe në ekosisteme është parashikuar në përputhje me vlerat minimale të pranueshme sipas legjislativës në fuqi si për stoket e depozitimit të mineralit dhe sterilit, shkarkimet në ajër dhe shkarkimet në ujë. Vendi në të cilin do të kryhet depozitimi i mbetjeve është i sigurt, nuk përben asnjë rrezik për mjedisin e komunitetit.

Mbetjet minerare është parashikuar të trajtohen sipas karakteristikave të tyre, përberjes dhe dekompozimit. Menaxhimi i mbetjeve është parashikuar që të parandalojë ngjarjet aksidentale, të minimizojë dukuritë efektive negative në mjedis dhe të garantojë marrjen e masave efektive dhe me kosto të ulët. Projekti siguron dhe sugjeron monitorimin e vazhdueshëm dhe informimin e hollësishëm për punimet e kryera lidhur me depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve minerare. Rekomandohet shoqërisë që të gjitha veprimet që lidhen me mjedisin të jenë të koordinuara ndërmjet autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Nisur nga fakti se sasia e sterilit që do të prodhohet do të jetë e vogël. Duke shfrytëzuar kushtet e terrenit të thyer sterili do të shkarkohet në stok, dhe ky material mund të përdoret edhe për nevojat e komunitetit si shtrim rrugësh etj.. Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetësor i

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posatshem dhe do te transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant te perdoruar do t'u jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne edhe ne Shqiperi (Ministria e Mjedisit posedon nje liste te subjekteve riciklues).

Ne tabelen e meposhteme jepet preventivi i shpenzimeve per menaxhimin e mbetjeve :

Preventiv per planin e menaxhimit te mbetjeve					
a	Çmontim paisje makineri, ndertesa ne siperfaqe	Volumi (ton)	Ore pune	Paga (lek/ore)	Vlera (lek)
		20	100	25	25000
b	Transport makineri, mbeturina	Volumi (ton)	Distanca (km)	Çmimi (leke/ton km)	Vlera (lek)
		20	30	12	7200
c	Mbushje me dhe' e portalit	Volumi (m ³)	Çmimi (lek/m ³)		Vlera (lek)
		100	30		3000
SHUMA II		35200			

Menaxhimi i mbetjeve

Material Mbetjesh	Vendi kryesor i germimit	Sasia		Trajtimi ose asgjесimi ne instalim/impiant (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi, riciklimi ose asgjесimi jashte instalimit / impiantit (Metoda, vendi, kontraktori)
		Ton/ muaj	m ³ / muaj		
Mbetje sterili	Shesh depozitimi	450	170	Ne pjesen lindore te zones se lejuar per shfrytezim eshte ndertuar sheshi i depozitimit te mineralit dhe te sterilite. Sheshi i depozitimit te mineralit do te jete relativisht i vogel pasi sasia e	Nuk rikuperohen, riciklohen dhe asgjесohen. Ato mund te perdoren nga te tretet per shtrim rruges te kategorive te ndryshme.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

				depozituar ne te e mineralit do te jete e vogel.	
--	--	--	--	--	--

8 NJË PËRSHKRIM TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË RËNDËSISHME TË PROJEKTIT TË PROPOZUAR MBI MJEDISIN

Ndikimet negative në mjedis:

- Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit;

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe më analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të rinovueshme.

Industria minerare është shumë e rëndësishme në ekonominë e një vendi, por ajo shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme. Shumë prej ndikimeve negative mjedisore mund të minimizohen përmes një planifikimi të kujdesshëm mjedisor dhe aplikimit të teknikave dhe teknologjisë së parandalimit të ndotjeve.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Kur flasim për shfrytëzim të resurseve minerare duhet të marrim në konsideratë përdorimin e makinerive të rënda si dhe zhvendosjen e transportin e sasive të mëdha të mineralit nga karriera.

Bazuar në mënyrën e propozuar për shfrytëzim ndikimet më thelbësore mund dhe duhet të analizohen sipas fazave të veprimtarisë, konkretisht, në fazën përgatitore, instalimeve, rikonstruksionit të punimeve ekzistuese dhe kryerjes së punimeve të reja në fazën e shfrytëzimit në fazën e mbylljes, rehabilitimit të objekteve dhe riaftësimi të proceseve natyrore.

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne toke

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te levizjes ne rrugen e hapur, punimet e hapura.	Sasi te vogla dheu gjenerohen. Kjo sasi dheu mund te sistemohet pergjate rruges dhe te perdoret ne fazen e fundit per qellime rehabilitimi dhe mbushjeje.
2	Levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit mbi siperfaqen e tokes.	Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve dhe mjeteve gjate punimeve te rikonstruksionit dhe atyre te reja do te limitohen brenda siperfaqes se kerkuar.
3	Erozion minimal ne kohe me rreshje ne siperfaqen ku eshte hapur karriera.	Largimi i grimcave te tokes qe ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt trupave ujore si perrenj dhe proskat ne afersi te objektit.
4	Avari teknike, derdhje e karburanteve dhe lubrifikanteve.	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjeve te karburanteve e lubrifikanteve , por per shkak te vellimit jo te madh te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete ne sasi te vogla.
5	Vibracion si pasoje e germimeve dhe nga levizja e makinerive	Gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje vibracion normal teknologjik.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer.

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Shkarkim i sasive minimale te gazeve nga automjetet dhe makinerite qe punojne me karburant dhe kohen e shperthimit te minave.	Ndotje e ajrit. Sasia e gazeve NO _x dhe SO _x qe do te shkarkohet eshte standart i teknologjise se automjeteve dhe makinerive qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara.
2	Emetim zhurmash nga automjetet dhe mjetet e punes.	Ndotje akustike. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

		banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe dhe nje pjese e tyre do te kryhen ne nentoke.
3	Krijimi i sasive te pluhurit si pasoje e qarkullimit te kamioneve gjate transportit te mineralit.	Ndotje ajri. Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojte kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne biodiversitet.

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasopjat ne mjedis
1	Nderhyrje ne habitatet ne zone.	Dentim i habitateve. Siperfaqja ku do te kryhen punimet e shfrytezimit eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit , do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore.

Identifikimi i ndikimeve te mundeshme negative ne peisazh.

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Ndikime ne peisazh dhe topografinë e terrenit ku ndodhet objekti.	Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime te pjerresise se terrenit dhe ato vizuale te pejsazhit. Gjithashtu ndikime do te kete edhe ne zhvillimin e proceseve te tokeformimit etj. ne

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

	sipërfaqen e prekur.
--	----------------------

Identifikimi i ndikimeve te mundeshme nga mbetjet e ngurta.

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat me mjedis
1	Gjenerim i mbetjeve te ngurta nga aktiviteti njerezor.	Ndotje urbane. Kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve.

Gjithashtu, gjatë të gjithë operacioneve të punës mund të ndodhë erozion minimal, sidomos në kohë me reshje. Për të mos u ndikuar kanalet kullues të zonës nga mbushja me llumra dhe shtimi i përmbajtjes së materies së ngurtë në ujërat shërbejnë kanalet perimetrikë në anët e pjerrëta të vendshfrytëzimit.

- Ndikimet sociale të projektit, të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit si: (zhurmat, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj.);

Nisur nga natyra e veprimtarisë që kërkon përdorimin e makinerive dhe lëndëve plasëse dhe duke marrë në konsideratë faktorë natyrorë që mund të favorizojnë shfaqjen e situatave jo të zakonshme, gjatë fazës së operimit mund të identifikohen edhe ndikime të tjera si: Erozioni dhe lëvizja e grimcave minerale nga objekti, që do të thotë ushtrimi i ndikimit të tyre jashtë kufijve të objektit, me pasojë sidomos në trupat ujorë të zonës. Erozioni do të kontrollohet përmes masave të parashkuara në Planin e Menaxhimit. Sterilet do të sistemohen dhe përdoren gjatë rehabilitimit duke shërbyer si fazë ndarëse midis shkëmbit dhe masës së dheut. Në këtë mënyrë ato shërbejnë për stabilizimin dhe krijimin e agregateve strukturore të tokës, porozitetin dhe drenazhimin.

Ndikim i botës së gjallë nga veprimtaria. Megjithë kohëzgjatjen e shkurtër të parashikuar për shfrytëzimin e veprimtarisë, lloje të ndryshme faunistike në objekt do të gjenden nën presion të vazhdueshëm, sidomos nga zhurmat. Këto ndikime janë të pashmangshme por masat për zbutjen e tyre mund të rezultojnë të suksesshme në fazat e ndryshme të zhvillimit të biodiversitetit, veçanërisht gjatë ciklit të riprodhimit. Këto masa do të mund të zbatohen me më tepër efikasitet gjatë vitit të dytë të shfrytëzimit mbasi të jetë njohur mirë sjellja e biodiversitetit në objekt. Njëkohësisht mund të ndodhë dëmtim habitati dhe folesh të llojeve biologjike me status të veçantë mbrojtjeje. Gjatë kësaj faze do të ndodhin disa ndryshime të pakthyeshme dhe të pashmangshme në pejsazhin, topografinë dhe gjeologjinë e sipërfaqes ku do të tërhiqet minerali. Siç shihet edhe nga profili gjeometrik i karrierës (shih raportin teknik) do të krijohen shkallë paralele të cilat do të paraqiten si brezare të gjelbëruara në fazën e rehabilitimit të karrierës.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Duhet kuptuar që probabiliteti që secili nga skenarët e mësipërm të ndodhë do të varet shumë nga masat që do të parashikohen dhe zbatohen në Planin e Menaxhimit.

- Në varësi të natyrës së projektit, një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis.

- Metodatat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis;

- Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:
- njohja me projektin dhe teknologjinë e tij, mënyra e propozuar për shfrytëzim,
- njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis,
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes,
- historiku i ndërveprimit mjedisor të minierës me zonën,
- konsultimi me shumë dokumenta e raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

-Shtirirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuar (shkalla);

- Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte);

Lloji i ndikimit		Sinjifikanca e ndikimit (sa i madh është ndikimi ose sa thelbësor)		
		I ulët	I mesëm	I lartë
1	Shqetësim i shtresës së tokës. Përshatje e rrugës për të mundësuar hyrjen në objekt të mjeteve			
2	Pastrimi i zonës së parkimit dhe mbajtjes së makinerive (pretje shkurresh dhe bimësh barishtore)			
3	Ngjeshje e pjesëve të tokës nga lëvizja e automjeteve të transportit			
4	Gjenerim i dherave dhe masave të shkurreve që do të dalin nga rregullimi i rrugës dhe sheshimi i sipërfaqeve ku do tëmbahet makineria			
5	Emetim zhurme, gazrash, arome, vibracion dhe pluhur			
6	Erozion minimal në kohë me reshje në sipërfaqen e vendshfrytëzimit			
7	Ndotje e tokës si pasojë e avarive të			

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

	mekanikes			
8	Ndikime në pejsazhin, gjeologjinë, dhe topografinë			
9	Ndikime në botën e gjallë (faunën)			
10	Gjenerim i mbetjeve të ambalazheve etj			

- Mundësia e zbutjes së ndikimeve dhe argumentimet përkatëse nëse për ndikime të caktuara nuk mund të zbatohen/ndërmerren masa zbutëse;

Qëllimi kryesor i përgatitjes së planit të masave është shmangia, zbutja dhe kompensimi i mundshëm i ndikimeve negative me qëllim që të reduktohen ndikimet deri në nivelet e pranuar. Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mire ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga operacionet e punës të përshkruar më sipër, kompania nëpërmjet personelit të saj ka përpiluar dhe do të zbatojë një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis.

-Mundesia e zbutjesse ndikimeve dhe argumentimi nese per ndikime te caktuara nuk munde te merren masa për zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Qëllimi kryesor i përgatitjes së planit të masave është shmangia, zbutja dhe kompensimi i mundshëm i ndikimeve negative me qëllim që të reduktohen ndikimet deri në nivelet e pranuar. Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mire ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga operacionet e punës të përshkruar më sipër, kompania nëpërmjet personelit të saj ka përpiluar dhe do të zbatojë një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis. Nder masat kryesore për zbutjen e ndikimit do të jene:

- Piketim të saktë të sipërfaqes së shfrytëzimit dhe operim vetëm brenda saj,
- Kontrolli i pluhurave përmes lagjes së zonës së punës dhe mbulimit të kamionëve gjatë transportit,
- Kontrollin e dherave të gjeneruara dhe sistemimin e tyre me anë të kompaktësimit të dherave dhe mbjelljes së shkurreve që do të dalin nga pastrimi dhe hapja e karrierës me qëllim rivegetacionin e shkallëve,
- Hapjen e kanaleve të nevojshëm për të drejtuar ujërat e shiut dhe erozionin,
- Përdorim të mirëplanifikuar dhe kontrolluar sipas rregullores së sigurisë të lëndëve plasëse
- Kontroll teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjet e karburantit.

- Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj.);

9. NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT

Nuk ka ndikime në mjedisin ndërkufitar të projektit

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

10. NDIKIMET POZITIVE NË MJEDISIN E ZONËS SË PROJEKTIT.

Nuk ka ndikime pozitive në mjedisin e zonës së projektit gjate fazes se shfrytezimit. Pas mbylljes se ketij aktiviteti ma masat qe shoqeria do te marre per rehabilitimin e mjedisit, do te kete ndikime ne peisazhin e siperfaqes se shfrytezuar dhe ne zhvillimin e flores.

11. MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

Qellimi kryesor i pergatitjes se planit te masave eshte shmangja , zbutja dhe kompensimi i mundshem i ndikimeve negative me qellim qe te reduktohen ndikimet deri ne nivelet e pranuar. Per te shmangur dhe menaxhuar se me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga operacionet e punes te pershkruara me siper , subjekti nepermjet personelit te saj ka perpiluar dhe do te zbatoje nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis.

Masat qe do te merren per zbutjen e ndikimit :

ndikimet mjedisore te karrieres do te zvogelohen duke zbatuar me korektesi teknikat e meposhteme :

- Piketim te sakte te siperfaqes se shfrytezimit dhe operim vetem brenda saj.
- Konbrolli i pluhurave permes lagjes se zones se punes dhe mbulimit te kamioneve gjate transportit.
- Kontrollin e dherave te gjeneruara dhe sistemimin e tyre me ane te kompaktesimit te dherave dhe mbjelljes se shkurreve qe do te dalin nga pastrimi dhe hapja e karrieres me qellim rivegjetacionin e shkalleve.
- Hapjen e kanaleve te nevojshme per te drejtuar ujrat e shiut dhe erozionin.
- Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjen e karburantit. Masat e zbutjes te ndikimit ne fazen e pergatitjes per shfrytezim te objektit.

Masat per mbrojtjen e tokes.

Nr.	Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
1	Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te levizjes ne rrugen e hapur.	Sasia e dheut mund te sistemohet pergjate rruges dhe te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te minieres.
2	Ngjeshje e pjeseshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione, etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara.
3	Erozion siperfaqesor ne mot me rreshje.	Do te hapen kanalet e drenazhimit ne siperfaqe. Pergjate segmenteve te rruges ne varesi te terrenit dhe kushteve te tokes do te hapen kanale anesore qe do te ndalin foren gerryese te ujrave te rreshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mineralit dhe hyrjes ne nentoke do te hapen kanale perimetrike

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

		kufizuese qe do te frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjeresise nga ujrat siperfaqesore. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen fitoklimatike.
4	Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes.	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit do te kontrollohen per gjendjen teknike te tyre dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrifikante do te zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis, do te merren masa per pastrimin e menjehershem te tokes se ndotur e cila do te depozitohet ne nje kazan te posacem metalik ose prej betoni per tu trajtuar me pas.

Masat per mbrojtjen e ajrit .

Nr.	Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
1	Emetime te pluhurit , zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracioneve.	Makinerite duhet te mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet te perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot duhet te kene ne gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave. Do te perdoret nafta me permbajtje te ulet squfuri. Te menjahohet renia e borive te automjeteve per te mos krijuar zhurme dhe stres tek punetoret. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara te behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por dhe krijimin e pluhurave.

Masat per mbrojtjen e pejsazhit.

Nr.	Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
1	Ndikime ne peisazh dhe topografine e relievit.	Gjate shfrytezimit nuk duhet te demtohen siperfaqe te panevojshme si pasoje e mos planifikimit te sakte apo e neglizhences se punetoreve qe mund te presin peme apo te shkaktojne zjare dhe demtojne pejsazhin dhe bimesine e zones.

Masat per mbrojtjen e biodiversitetit.

Nr.	Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
1	Ndikime ne faune.	Shoferet do te udhezohen te bejne kujdes gjate transportit ne zona pyjore per te mos shtypur kafshe qe

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

	mund të jenë në mes të rrugës. Ato duhet të kalojnë në rrugë të lira.
--	---

Masat për administrimin e mbetjeve urbane.

Nr.	Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
1	Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njëzësor.	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetësor i punëtorëve apo ambalazhet do të grumbullohen në vende të posaçme. Ato do të transportohen drejt qendrave me të afërta të banuara për menaxhim nga sektoret përkatës të pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant i përdorur do të jepen subjekteve që merren me riciklimin e tyre dhe që aktualisht operojnë në shqipëri.

12. PROGRAMIN E MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT.

Në përgatitjen e programit të monitorimit është menduar që të përzgjidhen për t'u monitoruar nga vetë kompania ata elementë që realisht mund të identifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen në organet e administrimit të mjedisit (ARM). Të dhënat cilësore, sipas tabelës do të hidhen në një regjistër që administrohet nga vetë kompania dhe do të dorëzohen në ARM-në e qarkut sa herë të kërkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve. Më poshtë jepen disa indikatorë të cilët duhen monitoruar për të vlerësuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore të projektit. Interpretimi i një gjendje të caktuar mjedisore duhet bërë në lidhje të ngushtë me fazën në të cilën gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se një gjendje e përkeqësuar e mjedisit në një fazë të caktuar të zbatimit e cila është fazë tranzitore dhe jo tregues absolut i realizimit të objektivave të projektit.

Elementet e monitorimit të veprimtarisë gjatë zbatimit të projektit

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1.	Monitorim i zhurmave dhe pasojave të plasjeve në minierë	Vazhdueshëm
2.	Monitorimi i biodiversitetit në zonën rreth objektit të shfrytëzimit	Vazhdueshëm
3.	Monitorimi i pluhurave në objekt dhe gjatë transportit	Gjatë stinës së thatë
4.	Monitorimi i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për rrjedhje dhe ndotje	Vazhueshëm

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

5.	Monitorim i faktorëve që shkaktajnë rreziqe natyrore dhe humane	Vazhdueshëm
----	---	-------------

Efikasiteti i masave të Planit të Menaxhimit do të vlerësohet nga rezultatet e tij konkrete në terren nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm. Plani i Menaxhimit do të përmiresohet dhe përshtatet në të ardhmen në varësi të kërkesave praktike.

13. PLANIN E MENAXHIMIT MJEDISOR

- Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar për mbrojtjen e mjedisit, në secilën fazë të projektit;

PMM-ja për një komponent Projekti apo një nënprojekt do të përmbajë:

- Vlerësimin e impakteve mjedisore të parashikuara në faza të ndryshme, veçanërisht gjatë periudhes së shfrytëzimit, periudhat kohore gjatë të cilave do të kryen fazat e mësipërme, shkallën e tyre, qëllimin dhe pasoja(t).
- Përcaktimin e nivelit të pranueshëm të secilit impakt, veçanërisht në lidhje me periudhën kohore, zgjatjen në kohë, shkallën, pasojën (t), koston (t), dhe nivelet e lejuara ligjore.
- Kushtet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur këto impakte që ka mundësi të dalin në çdo fazë, cilët do të jenë përgjegjës për to, nëse duhet përmirësuar projekti teknik, ose nëpërmjet masave mbrojtëse gjatë Shfrytëzimit, apo metoda të tjera, kostot e mundshme, implikimet për përfundimet e projektit, etj.
- Burimet dhe metodat e kërkuara për monitorimin, matjen dhe vënien në zbatim të tyre (çfarë është për t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse); përgjegjësitë institucionale për secilin veprim; dhe kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, dhe kostot përkatëse të secilit element.
- PMM-ja do të përmbajë dy dokumente të veçanta: një Plan Zbutës, që merret me aspektet e përshkruara më sipër, dhe një Plan Monitorues që merret me aspektet e përshkruara më sipër. Pritet që të përgatiten në kohën e finalizimit të përfundimit të projektit teknik dhe duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e specifikuar në Vendimin për VNM-në e thelluar të lëshuar nga AKM-ja.
- NJQV-ja ose propozuesit (nëse nuk janë të njëjtë) do të jenë përgjegjës për përgatitjen e PMM-së. Megjithatë në Termat e Referencës së projektuesit të projektit përfshihet përgatitja e PMM. Aty ku nënprojekti kërkon një VNM, do të kërkohej mendimi i specialistëve të VNM para se ky i fundit të finalizohet.

Subjekti do të kujdeset për administrimin e çdo informacioni që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë. Administrimi i të dhënave konsiderohet shumë i rëndësishëm për mënyrën e operimit të subjektit dhe do të përdoret për të përmirësuar efikasitetin e çdo mase të parashikuar për zbutjen e ndikimeve në mjedis dhe në tërësi. Për mbajtjen e të dhënave do të përpilohet një regjistër i veçantë,

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

fushat e të cilit të mbulojnë të gjithë llojin e informacionit të mbledhur që lidhet me aktivitetin e minierës.

Aktiviteti i shfrytëzimit si aktivitet mineral vepron në sipërfaqe. Pjesa e relievit ku do të zbatohet aktiviteti është praktikisht e pacënuar por e varfër nga mungesa e bimësisë. Në përfundim të aktivitetit, do të duhet që të transformohen sipërfaqet e dëmtuara në një reliev të ri natyror, në një sipërfaqe në formën e sotme por të mbuluar nga vegjetacioni, dhe në terene të gjelbëruara.

Mbas shfrytëzimit të objektit dhe mbylljes së veprimtarisë është planifikuar të realizohen punime rehabilitimi të konceptuara në dy faza sipas natyrës së punimeve dhe qëllimit të tyre.

Operacionet për rehabilitimin e karrierës do të realizohen,

- Për largimin e makinerive,
- Për sistemimin dhe përshtatjen e sipërfaqes së karrierës për rehabilitim,
- Për mbjelljet dhe kujdesin për rehabilitimin e karrierës.

Ndikimet më të mundshme që lidhen me këtë fazë janë:

- Emetime pluhurash dhe zhurmash gjatë procesit të çmontimit dhe sistemimit të dherave nëpër shkallët e karrierës,
- Emetime gazrash si pasojë e lëvizjes dhe transportit të pajisjeve,
- Derdhje aksidentale karburanti dhe hidrokarburesh nga mjetet e transportit.

Këto janë ndikime të pashmangshme plotësisht por kompania do të marrë masat e duhura që të minimizohen në maksimum, sidomos duke planifikuar efikasitetin dhe ulur kohëzgjatjen e realizimit të operacioneve.

Masat për rehabilitimin e sektorëve të sipërpermendur që çenojnë terenet do të zbatohen hap pas hapi, krahas aktivitetit të zbulimit dhe konsistojnë në:

- Sistemimin në sipërfaqen egzistuese ku do të zhvillohet zbulimi nepërmjet mbjelljes së pemëve për të rritur kohezionin e saj pasi të ketë përfunduar puna;
- Hapja e gropave ku do të mbillen fidanat dhe mbushjen e tyre me dhëra vegjetale;
- Mbjelljen e sipërfaqeve të krijuara si më sipër dhe sipërfaqeve të reja në territorin e zones me pemë natyrore dhe barishte të ndryshme;
- Mirembajtjen e sipërfaqeve të mbjella për një kohë 4 vjeçare pas dorëzimit të lejes së shfrytëzimit;

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zene punimet e projektuara, në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Preventivi i rehabilitimit per 1 ha per zonen e shfrytezuar								
Nr.	Operacioni	Siperf.	Norm ha/ha	Sip. Oper ha	Norm. m ³ /ha oper.	Volumi i punes m ³	Çmimi lek/ha	Vlera
I	Plani i mbylljes se karrieres							
a	Krehje sistemim i faqeve anesore	1	0.7	0.7	200	140	50	7000
	Shuma I	7000						
II	Plani i menaxhimit te mbetjeve							
a	Sistemim i mbetjeve te zbulimit	1	1	1	1800	1800	15	27000
b	Sistemim i mbetjeve teknologjike	1	0.1	0.1	2000	1800	15	27000
	Shuma II	54000						
III	Plani i rehabilitimit perfundimtar i mjedisit							
a	Mbushje me dhe produktiv i sheshit fundor	1	1.1	1.1	3000	3300	35	11550
b	Hapje gropash	1	1	1	300	300	100	30000
c	Blerje pemesh	1	1	1	300	300	1000	300000
d	Mbjellje pemesh	1	1	1	300	300	50	15000
e	Sherbime	1	1	1	300	300	50	15000
			norm ml/ha		gjatesia ml	volumi m ³	çmimi	
f	Kanali i ujrave te larta, drenazhim	1	300		300	75	200	15000
	Sinjalistike							5000
	Shuma III	495500						
	Shuma (I+II+III)	556500						
	Shpenzime suplementare 5%	27825						
	Totali	584325						

- Plani i komunikimit dhe informimit të publikut për ndikimet në mjedis, masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit.

Vlerësimet e ndikimeve në fazën e shfrytëzimit mund të ndryshojnë me atë të fazës përgatitore dhe instalimit të teknologjisë, megjithatë disa lloje ndikimesh, pasojat dhe receptorët e ndikimeve janë të njëjtë me të parët si p.sh. emetimi i pluhurave. Ky ndikim është i njëjtë nga pikpamja cilësore, por ndryshimi në fazën e shfrytëzimit qëndron në aspektin sasior të tij si p.sh. kohëzgjatja e ndikimit, ekspozimi ndaj tij pasi lidhet edhe me hartën e transportit, vlera e ndikimit apo sinjifikanca e tij.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

Në përgatitjen e programit të monitorimit është menduar që të përzgjidhen për t'u monitoruar nga vetë kompania ata elementë që realisht mund të indentifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen në organet e administrimit të mjedisit (ARM). Të dhënat cilësore, sipas tabelës do të hidhen në një regjistër që administrohet nga vetë kompania dhe do të dorëzohen në ARM-në e qarkut sa herë të kërkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve. Më poshtë jepen disa indikatorë të cilët duhen monitoruar për të vlerësuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore të projektit. Interpretimi i një gjendje të caktuar mjedisore duhet bërë në lidhje të ngushtë me fazën në të cilën gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se një gjendje e përkeqësuar e mjedisit në një fazë të caktuar të zbatimit e cila është fazë tranzitore dhe jo tregues absolut i realizimit të objektivave të projektit.

Shoqëria gjate gjithë fazes se zbatimit te ketij projekti ka komunikuar dhe informuar publikun lidhur me ndikimet në mjedis, masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit .

14. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për projektin "**Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret**", është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i projektit është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë shfrytëzimit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit , në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI “ DUKAGJIN” MAT

- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.
-

Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “monitorim i gjendjes së mjedisit”;
- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e Vendimit Thelluar të VNM-së.

Tabela. Baza ligjore për monitorim

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës nëMjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit tëMjedisit
VKM nr.103 datë 31.03.2002	“Për monitorimin e mjedisit në Republikën eShqipërisë
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kulë të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra ekontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010

Në përputhje me karakteristikat e implementimit te projektit “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”,dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Tabela. Monitorimi i parametrave mjedisore

Nr.	Monitorimi	Parametrat që do të monitorohen	Periudha kohore	Frekuenca	Përgjegjësia
1	Cilësia e Ajrit	PM10, SO2, NOx, CO , CO2 ,HC	Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor
2	Emetimi i zhurmave	Niveli i zhurmave në dB	Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor
3	Monitorimi ishpejtësisë maksimale të valës zanore(PPV)		Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

4	Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë
5	Avari apodefekte të ndryshme tëmundshme gjatëoperimit	Regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë dhe Drejtuesi i Punimeve
6	Dëmtim ivegjetacionit apo të mbjellave	Regjistrohen	Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 6 muaj	Eksperti i Mjedisit
7	Monitorim i zbatimit tëkushteve të Vendimit të VNM-së se thelluar	Monitorohen, regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit dhe ne vazhdim	Çdo 6 muaj	Eksperti i Mjedisit & Inspektoriati përkatës

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore përsa i përket monitorimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave.

Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv,

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë"

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis gjate zhvillimit te Projektit dhe konkretisht elementët e mëposhtëm:

- Për ajrin duhet të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat (dB).
- Për ujin, nuk aplikohen detyrime
- Për token, nuk aplikohen detyrime

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të Vendimit të VNM-së se Thelluar dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër per zhvillimin e projektit të shoqëruara me foto.

Raporti i Thelluar per Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis shikohet ne perfundim te tij si i pranueshem per zhvillimin e ketij projekti. Kjo edhe per faktin se gjate gjithë kohes qe prej eskpertsit behej vezhgimi, verifikimi dhe kontrollimi i plotesimit te kushteve te ligjshmerise mjedisore por edhe me tej ne vazhdimesi, drejtuesi i subjektit qe do te kryeje projektin tregoi interesim dhe

RAPORTI I THELLUAR I VNM OBJEKTI " DUKAGJIN" MAT

vleresim pozitiv per krijimin e kushteve mjedisore dhe zbatimin e rekomandimeve per mjedisin si dhe ne hartimin sa me te plote te ketij Raporti Mjedisor.

Duke pare masat e marra ne teresine e tyre ne permbushjen e kerkesave te ligjshmerise mjedisore, teknologjike e thjeshte qe do te aplikohet ne rruge te modernizuar, impenjimin per realizimin e ndertimit dhe permiresimet e treguesve mjedisore, mendojme se projekti qe do te kryhet ne kete zone nga subjekti nuk do te kete pasoja negative te dukshme te cilat mund te sjellin probleme me ndikim ne mjedis.

Si perfundim mund te themi se projekti qe do te zhvillohet konsiderohet i pershtatshem dhe i pranueshem ne zonen e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore per zonen perreth.

Hartoi materialin
STUDIO MJEDISORE
"REAL - P" sh.p.k.
Eksperti i Vlersimit e Auditimit Mjedisor
Ing. Remzi PUPLI

Ing. Perparim LIKA



Çertifikuar nga Ministria e Mjedisit
Nr. 427 Prot, Vendimi Nr. 9, Nr.244 regj.
date 01.08.2007

